



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM LËNDOR PËR ARSIMIN BAZË  
PËR FËMIJËT E NGUJUAR**

**Lënda: TIK**

**Klasat: VI, VII, VIII, IX**

**Tiranë, 2018**



	Emër Mbiemër	Pozicioni	Data	Nënshkrimi
Koordinoi:	I.Sina	Drejtore i Drejtorisë së Metodologjisë dhe Teknologjisë në Mësimdhënie	___.11.2018	
Pranoi:	D.Rapti	Drejtore i Drejtorisë së Kurrikulës, Standardeve dhe Kualifikimit	___.11.2018	

## Përmbajtja e Programi

I.	Hyrje.....	4
II.	Korniza konceptuale e programit.....	4
III.	Qëllimet e arsimit parauniversitar .....	7
IV.	Qëllimi i programit të fushës “Teknologji dhe TIK” .....	8
4.1	Qëllimi i fushës.....	8
V.	Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës .....	9
VI.	Lidhja e TIK-ut me fushat e tjera kurrikulare .....	13
VII.	Kompetencat që formohen përmes tematikave .....	15
VIII.	Koha mësimore për secilën klasë.....	18
8.1	Përmbajtja e shkallës së tretë.....	18
IX.	Shkalla e tretë .....	20
9.1	Tematika : Bota e kompjuterit .....	20
9.2	Tematika: Përpunimi digjital i tekstit dhe analiza e të dhënave .....	22
9.3	Tematika: Kërkimi në web/internet dhe e-mail-i .....	26
9.4	Tematika: Botimet dhe siguria në internet.....	29
9.5	Tematika: Prezantimi digjital .....	31
X.	Programi i shkallës së 4-rt: klasa e 8-të dhe 9-të .....	33
10.1	Tematika : Bota e kompjuterit .....	33
10.2	Tematika: Përpunimi digjital i të dhënave .....	36
10.3	Tematika: Kërkimi në web/Internet, e-maili dhe chat-i .....	40
10.4	Tematika: Hyrje në Programim dhe Excel-i .....	43
10.5	Tematika: Prezantimi digjital .....	46
	Programi klasa e 9-të .....	48
11.1	Tematika: Bota e kompjuterit .....	48
XI.	Udhëzime metodologjike .....	58
XII.	Udhëzime për vlerësimin .....	61

XIII. Materiale dhe burime mësimore .....	67
---	----

### **Tabelat dhe digramat**

<b>Diagrama 1 Korniza konceptuale e programit .....</b>	<b>6</b>
Diagrama 2 Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së TIK-ut për shkallën e tretë. ....	9
<b>Diagrama 3 Lidhja ndërmjet TIK-ut dhe fushave të tjera. ....</b>	<b>14</b>
Digrama 4 Kompetencat e fushës dhe tematikat e fushës.: .....	15
Tabela 1: Kompetencat e fushës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të fushës .....	16
Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë.....	18

## I. Hyrje

Në kohët e sotme, teknologjia dhe TIK-u janë kthyer në një mënyrë jetese ndaj së cilës fëmijët janë të tërhequr. Për t'iu përshtatur sa më mirë ndryshimeve të kohës, është i nevojshëm integrimi i TIK-ut në ciklin fillor pasi ndikon në zhvillimin e kompetencës digjitale të të gjithë nxënësit. Fëmijët e sotëm fillojnë të përdorin mjetet digjitale në një moshë shumë të re, ndaj shkolla duhet t'u përgjigjet nevojave të nxënësit.

Arsimi teknologjik është një komponent thelbësor i kurrikulës. Në një botë, ku ndeshesh me shumë lloje teknologjish, të cilat janë pjesë e jetës së përditshme për të gjithë njerëzit, nxënësit duhet të pajisen me aftësi për t'u përballur me to me vetëbesim. Është po aq e rëndësishme që nxënësit të vlerësojnë dhe të kuptojnë marrëdhënien komplekse ndërmjet teknologjisë dhe shoqërisë. Si qytetarë, ata duhet të jenë të aftë të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Nxënësit e moshës digjitale vijnë në shkollë me njohuri, gjykime, opinione dhe pyetje të mara nga burime të pafundme digjitale të informacionit të cilat mësuesi duhet t'i konsiderojë si pjesë të kurrikulës në tërësinë e saj.

TIK-u dhe teknologjia janë një formë e veçantë e veprimtarisë krijuese, ku njerëzit ndërveprojnë me mjediset e tyre duke përdorur materialet, inputet dhe proceset e duhura në përgjigje të nevojave, dëshirave dhe mundësive të tyre. Ajo integron shprehitë për zgjidhjen e problemeve dhe ato praktike në prodhimin e produkteve dhe të sistemeve të dobishme. Për këtë arsye ajo është e pranishme në shumë fusha të të nxënësit, por veçanërisht në fushën e shkencave natyrore.

## II. Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga: Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë:

Si i tillë ky dokument i shërben:

- **nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave të fushës së teknologjisë dhe TIK-ut, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohen në shoqëri;
- **mësuesit** për planifikimin realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj;
- **prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriterëve të vlerësimit në periudha të caktuara kohore;
- **hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.


Programi i TIK-ut ka në thelb të tij krijimin e kushteve për ndërtimin e **kompetencave të fushës/lëndës** si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet fushës së teknologjisë dhe TIK-ut është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e tij në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e tik-ut me fushat e tjera, në mënyrë që kurrikula e arsimit bazë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Programi përmban 5 tematika, të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Në program paraqiten edhe **koha mësimore për secilën tematikë**, që ndryshon nga klasa në klasë.

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënie është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Në këtë program **vlerësimi i nxënësve**, është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënit.

Programi i TIK-ut, nga pikëpamja e organizimit të përmbajtjes, paraqitet në diagramin e mëposhtëm:

Diagrama 1 Korniza konceptuale e programit



### **III. Qëllimet e arsimit parauniversitar**

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike, të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme, të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

#### **Në arsimin parauniversitar nxënësit:**

- kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes.
- përdorin teknologjitë e reja.



## **IV. Qëllimi i programit të fushës “Teknologji dhe TIK”**

### **4.1 Qëllimi i fushës**

- Të kontribuojë në një edukim të balancuar, duke iu dhënë nxënësve një përvojë të gjerë dhe sfiduese, që do t’u krijojë mundësi atyre të fitojnë një grup njohurish, kuptimesh, aftësish njohëse e përpunuese dhe kompetenca të thjeshta, duke i përgatitur në këtë mënyrë që të jenë pjesëmarrës në një botë teknologjike.
- T’u krijojë mundësi nxënësve t’i integrojnë këto njohuri dhe shkathtësi/shprehi, së bashku me cilësitë për hulumtim dhe mendimin reflektiv, për gjetjen e zgjidhjeve me vëmendjen e duhur ndaj çështjeve të shëndetit dhe sigurisë.
- Të lehtësojë zhvillimin e një sërë aftësive të komunikimit, që do t’i nxisin nxënësit të shprehin aftësitë e tyre krijuese në mënyrë praktike dhe me imagjinatë, duke përdorur varietet formash: fjalë, grafikë, modele etj.
- Të sigurojë një kontekst, në të cilin nxënësit mund të zbulojnë dhe vlerësojnë ndikimin e teknologjive në ekonomi, në shoqëri dhe në mjedisin përreth.

### **Qëllimi i programit të TIK-ut:**

Programi i TIK-ut për ciklin fillor do të bazohet kryesisht në zhvillimin e procesit të shkruarit në kompjuter, bashkëbisedimit me të tjerët, si edhe realizimit të prezantimeve të ndryshme. Nxënësit do të aftësohen:

- të gjejnë informacione nga një shumëllojshmëri burimesh, të përzgjedhin dhe të sintetizojnë informacionin për të përmbushur nevojat e tyre;
- të zhvillojnë idetë të tyre, duke përdorur mjetet e TIK-ut për të përmirësuar cilësinë për të ndryshuar dhe përsosur punën e tyre;
- të shkëmbejnë dhe ndajnë informacione përmes medieve elektronike;
- të shqyrtojnë, ndryshojnë dhe vlerësojnë punën e tyre, duke reflektuar në mënyrë kritike për cilësinë e saj.

## V. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit tënxënit. ***Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.***

Kompetenca demonstron nga nxënësi (njohuri), bazohet në performancën e tij (aftësi), si dhe bazohet në perspektivën e sjelljes (qëndrim). Organizimi i mësimit të tik-ut me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën. Kur nxënësi realizon kompetencat digjitale, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe.

P.sh. kompetenca digjitale “Zgjidhja problemore” përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e përditshme duke përdorur teknologjinë.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës së TIK-ut mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultat-in/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetenca kyç për secilin vit mësimor rezultat-in/et e të nxënit për shkallë, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh rezultat-in/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e fushës/ lëndës së TIK-ut që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetencat e fushës/lëndës së tik-ut për vit mësimor, rezultat-in/et e të nxënit për shkallë;
- përzgjedh përmbajtje-en/et mësimore, mjetet digjitale, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave digjitale një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçenë një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për fushën e teknologjisë dhe TIK-ut.


**Diagrama 2 Rezultatet kryesore të tënxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së TIK-ut për shkallën e tretë.**

## Kompetenca digjitale

- **Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin**
- Përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Përdorimi digjital-i imazheve për të modifikuar ose krijuar vepra të artit për një prezantim digjital.
- Shpjegon avantazhet dhe disavantazhet në përdorimin e teknologjive të ndryshme për të afruar informacionin për dëgjues të synuar. (p.sh: krahasojnë komunikimin përmes videoeve dhe mjeteve të komunikimit masiv; e-mail, CD-messenger)
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).
- Përcakton mjetet e duhura teknologjike për qasjen në informacione dhe burime elektronike.
- Zhvillon aftësinë mediatike për identifikimin e burimit të informacionit dhe këndvështrimin analitik për gjykimin e tyre (p.sh., dallon nëse një material i marrë nga interneti është fakt dhe burimi është primar ose sekondar).
- Ndërton sisteme të teknologjisë së informacionit nëpërmjet mbledhjes, përpunimit dhe daljes së informacionit, si dhe të feedback-ut të marrë nga mësuesit ose nxënësit e tjerë.
- Debaton mbi ndikimin, avantazhet dhe dizavantazhet e teknologjive ekzistuese dhe të reja në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit.

## Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

- **Nxënësi komunikon në mënyrë efektive**
- Veçon informacionin kryesor nga një lburim digjital (internet, radio, TV etj..) e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyre me shkrim.
- Përdor programet softuerike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në distancë nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit (për nevojat e veta apo si detyrë shkollore).



**Diagrama 3 Rezultatet kryesore të tënxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së TIK-ut për shkallën e katërt.**

### **Kompetenca digjitale** *Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*

- Përdor TIK-un për të lehtësuar procesin e të nxënës dhe për të rritur efektivitetin në mësimnxënie;
- Përdor mjetet multimediale për të bashkëpunuar me persona të tjerë dhe për të rritur produktivitetin e tij dhe të nxënës efektiv;
- Bashkëpunon me moshatarët e tij duke përdorur mjetet e telekomunikacionit bashkëpunues, për të hetuar tema mësimore, për të zgjidhur çështje dhe probleme që mund të lindin në shkollë dhe jashtë saj;
- Krijon animacione origjinale ose dokumentarë, duke u bazuar tek ngjarjet e komunitetit, lokalitetit dhe mjedisit shkollor;
- Përdor me saktësi komandat e avancuara të programeve standarde për përpunimin e teksteve, tabelave, videove e fotografive për prezantime;
- Përdor aftësitë e të menduarit kritik për të planifikuar, hulumtuar e menaxhuar projekte, për të zhvilluar strategji, për të zgjidhur problemet dhe, arrin vendimarrje, në bazë të informacionit të fituar duke përdorur mjetet dhe burimet e duhura digjitale;

### **Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit** *Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*

- Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit;
- Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në grup, duke gërshtuar format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik;
- Identifikon burime të ndryshme informacioni për arsimim dhe orientim profesional, si dhe zhvillon një plan individual për zhvillimin e karrierës së tij.

### **Kompetenca e të menduarit** *Nxënësi mendon në mënyrë krijuese*

- Paraqet në forma të ndryshme (me gojë, të shkruar, grafike, me simbole) argumente për të përforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara;
- Përzgjedh dhe klasifikon informacionin nga burime të ndryshme në bazë të një kriteri të caktuar për një temë konkrete dhe e përdor për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre;
- Analizon një punim (p.sh. artikull gazete, pikturë ... etj) duke gjetur analogji dhe dallime me punime të ngjashme nga autorë të ndryshëm;

### **Kompetenca e të nxënës** *Nxënësi mëson për të nxënë*

- Regjistron në formë të shkruar, grafike, etj., informacionin/ faktet për një temë; veçon me anë të teknikave të ndryshme pjesët sipas rëndësisë dhe nevojës për temën/detyrën e dhënë.
- Shfrytëzon në mënyrë efektive fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burime të tjera për zhvillimin e një ideje /projekti me bazë klase/shkollë ose jashtë saj;
- Regjistron, skedon dhe përdor teknika të tjera për të menaxhuar informacionin/ faktet ose formulat për një temë duke i radhitur ato sipas llojit, burimit dhe rëndësisë.

### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin** *Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*

- Përdor programet kompjuterike për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizatimeve/diagrameve të nevojshme për përgatitjen e materialeve individuale apo/ dhe publikimeve të ndryshme të shkollës;
- Përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim dhe për orientim në karrierë.
- Propozon kriteret për vlerësim të paanshëm të një aktiviteti sportiv, shkencor, teknologjik, artistik, etj., (si anëtar jurie të ngritur në nivel klase, shkollë apo shoqërie civile).

### **Kompetenca personale** *Nxënësi bën jetë të shëndetshme*

- Përshkruan mundësitë, rreziqet, pasojat e infeksioneve, sëmundjeve seksualisht të transmetueshme duke sqaruar mënyrat dhe mjetet për parandalimin e tyre nëpërmjet prezantimit digjital;

### **Kompetenca qytetare** *Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*

- Reagon me mjete digjitale ndaj personave të cilët shkelin, çenojnë ose mohojnë të drejtat e të tjerëve duke dhe arsyeton pasojat e këtyre veprimeve për individin, grupin dhe komunitetin.

## VI. Lidhja e TIK-ut me fushat e tjera kurrikulare

TIK-u u shërben të gjitha fushave, me koncepte dhe me aftësi. Lidhja e TIK-ut me fushat e tjera pasuron situatat e mësimit, në të cilat nxënësi zhvillon kompetencat e tij. Përdorimi i teknologjisë në fushat si (“Gjuhët dhe komunikimi”, “Matematikë”, “Shkenca natyrore” etj.) ndihmon në përvetësimin më mirë të lëndëve të tjera nga nxënësi duke i bërë ato më të kuptueshme dhe më efektive). TIK-u luan një rol të rëndësishëm në të gjitha fushat e tjera. Përdorimi i TIK-ut duhet të shihet si një mjet që i ndihmon nxënësit të përqëndrohen më gjatë në klasë, pasi informacioni mund të transmetohet në forma të ndryshme: audio-vizive (eksperimentet virtuale, filmat dokumentarë, prezantime *PowerPoint*, postera, leximi i historive online, të ritregojnë historinë duke e rishkruar në *Word*, të ndajnë informacione me shkollat e tjera nëpërmjet *e-mail-it*).


Në studimin e matematikës nxënësi përdor programin *Excel* për të hedhur të dhëna matematikore, ata mund ta realizojnë nëpërmjet vizatimit të grafikëve, të cilët mund të shërbejnë më pas edhe për të realizuar analizën e të dhënave. Krijimi i një databaze ku të hedhim të dhënat për nxënësit: emër, mbiemër, datëlindja, vendlindja etj. Kjo database mund të përdoret më pas për përlllogaritje formulash kur nxënësit të kenë përvetësuar *excel-in*.

Në “Gjuhët dhe komunikimi” nxënësi bën korrigjimin në mënyrë automatike të gabimeve ortografike, vendosja e duhur e sintaksës. Gjatë dërgimit të *e-mail-eve*, shikohet nëse është zgjedhur adresa e saktë dhe nëse është përdorur gjuha e duhur ndaj dërguesit. Kur nxënësit mësojnë ndarjen e paragrafëve dhe të fjalëve, atyre u korrigjohet edhe ana linguistike, si dhe shihet nëse ndarja e paragrafëve është e saktë. Gjuhët e huaja mund të përdoren edhe si aftësi ndërkurrikulare. Nxënësve u kërkohet të gjenden informacione nga interneti dhe, më pas, ata mund të hartojnë rregullat e klasës, mund të shkruajnë një bibliografi të vogël për veten, mund të jenë në gjendje të krijojnë një faqe ku të vendosin punime të anglishtes, si dhe mund të organizojnë postera për tema të ndryshme që prekin jetën e përditshme. Nëpërmjet *CD-ROM* dhe *DVD* ata zhvillojnë më shumë fjalorin, duke e pasuruar atë dita-ditës. Ana vizuale i ndihmon nxënësit të mbajnë mend më shpejt dhe më lehtë shumë fjalë.

Në fushën e historisë nëpërmjet TIK-ut nxënësit mund ta përdorin internetin për të zgjeruar njohuritë e tyre mbi faktet historike, por edhe për të mbajtur mend më lehtë. P.sh. në lidhje me Luftën e Dytë Botërore, ata mund të gjejnë sekuenca filmike, dokumentarë, shkrime, që mund t'i ndihmonin për të mbajtur mend më lehtë ngjarjet. Gjithashtu në studimin e edukimit muzikor nxënësi nëpërmjet njohurive të TIK-ut përdor këto mjete për të përvetësuar më mirë lëndën e muzikës. Duke i ndjekur imazhet vizualisht ose duke krijuar pjesë të vogla muzikore nëpërmjet

përdorimit të teknologjive. Nëse nxënësit e dëgjojnë këngën, por në të njëjtën kohë kanë dhe mundësinë të shohin videoklipin e saj, kjo e bën më të lehtë mësimin e muzikës. Në diagramën e mëposhtme tregohet lidhja e TIK-ut me fushat e tjera.

*Diagrama 3 Lidhja ndërmjet TIK-ut dhe fushave të tjera.*



Korrigjimi në mënyrë automatike i gabimeve ortografike, vendosja e duhur e sintaksës. Gjatë dërgimit të *e-mail*-eve të shihet nëse është zgjedhur adresa e saktë dhe nëse është përdorur gjuha e duhur ndaj dërguesit. Kur nxënësit mësojnë ndarjen e paragrafëve dhe të fjalëve, atyre u korrigjohet edhe ana linguistike, si dhe shihet nëse ndarja e paragrafëve është e saktë. Nëpërmjet CD-ROM dhe DVD ata zhvillojnë më shumë fjalorin, duke e pasuruar atë dita-ditës. Ana vizuale i ndihmon nxënësit të mbajnë mend më shpejt dhe më lehtë shumë fjalë.

Të hedhurit e të dhënave matematikore, nxënësit mund ta realizojnë nëpërmjet vizatimit të grafikëve, të cilët mund të shërbejnë më pas edhe për të realizuar analizën e të dhënave. Krijimi i një databese ku të hedhim të dhënat për nxënësit: emër, mbiemër, ditëlindja, vendlindja etj. Kjo databese mund të përdoret më pas për përlogaritje formulash kur nxënësit të kenë përvetësuar excel-in.

Për të kuptuar më mirë eksperimentet, nxënësit ndjekin eksperimente, të cilat gjenden on line, dhe shumë lehtë edhe në faqen e [www.youtube.com](http://www.youtube.com), po edhe në faqe të specializuara për shkencat ekzakte. Nxënësit mund të organizojnë projekte kurrikulare, duke përdorur internetin për gjetje informacioni dhe PowerPoint-in për prezantim.


Nxënësit e përdorin internetin për të gjetur informacion në lidhje me fenomenet gjeografike dhe për të zgjeruar njohuritë e tyre mbi faktet historike. Gjithashtu, nëpërmjet internetit ata njohin më nga afër qytetet, të cilat mund t'i vizitojnë në të ardhmen. Për të kuptuar më mirë hapësirat, pozitat gjeografike dhe zhvendosjen në terren nxënësit përdorin [www.googlemap.com](http://www.googlemap.com)

Nxënësit i përdorin këto mjete për të përvetësuar më mirë lëndën e Muzikës. Duke i ndjekur imazhet vizualisht ose duke krijuar pjesë të vogla muzikore nëpërmjet përdorimit të teknologjive. Nëse nxënësit e dëgjojnë këngën, por në të njëjtën kohë kanë dhe mundësinë të shohin videoklipin e saj, kjo e bën më të lehtë mësimin e muzikës.

## VII. Kompetencat që formohen përmes tematikave

Bazuar në këtë kurrikul, programi i TIK-ut synon të përmbushë 6 kompetencat e fushës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 5 tematikave kryesore.

**Digrama 4 Kompetencat e fushës dhe tematikat e fushës:**





**Tabela 1: Kompetencat e fushës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të fushës**

Kompetencat e veçanta që formohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave
Kreativiteti dhe inovacioni	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <b><i>Kreativiteti dhe inovacioni duke përdorur teknologjinë:</i></b> përdor teknologjinë për të zhvilluar të menduarit krijues dhe konstruktiv apo për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin në produktet që realizon gjatë proceseve të punës.</li> <li>- <b><i>Zhvillimi i përmbajtjes:</i></b>të krijojë përmbajtje në formate të ndryshme duke përfshirë multimedian, të rregullojë dhe të përmirësojë përmbajtjen që ai ose të tjerët kanë krijuar, të shprehë kreativitetin nëpërmjet mediave dhe teknologjive digjitale.</li> <li>- <b><i>Integrimi dhe ripërpunimi:</i></b>të modifikojë, të pastrojë dhe përpunojë burimet ekzistuese për të krijuar përmbajtje dhe njohuri të reja, origjinale dhe të përshtatshme.</li> <li>- <b><i>E drejta e autorit dhe licencat:</i></b> të kuptojë si e drejta e autorit dhe licencat zbatohen në informacionin dhe përmbajtjen.</li> <li>- <b><i>Programimi:</i></b> të aplikojë parametrat, modifikime programi, aplikime programi, software, pajisje, të kuptojë parimet e programimit, të kuptojë çfarë është pas një programi.</li> </ul>
Komunikimi dhe bashkëpunimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <b><i>Bashkëveprimi ndërmjet teknologjisë:</i></b> të bashkëveprojë nëpërmjet llojeve të ndryshme pajisjesh dhe aplikacioneve digjitale, të kuptojë se si komunikimi digjital është shpërndarë, paraqitur dhe drejtuar, të kuptojë rrugët e përshtatshme të komunikimit nëpërmjet mjeteve digjitale, t'u referohet formateve të ndryshme të komunikimit, të përshtasë modelet dhe strategjitë e komunikimit për një audiencë specifike.</li> <li>- <b><i>Shpërndarja e informacionit dhe përmbajtjes:</i></b> të ndajë me të tjerët vendndodhjen dhe përmbajtjen e informacionit të gjetur, të jetë i gatshëm dhe në gjendje për të ndarë njohuritë, përmbajtjen dhe të veprojë si ndërmjetës, të jetë aktiv në shpërndarjen e të rejave , përmbajtjeve dhe burimeve, të dijë rreth praktikave dhe të integrojë informacion të ri në trupin e njohurive ekzistuese.</li> <li>- <b><i>Angazhimi i qytetarisë online:</i></b> të marrë pjesë në shoqëri nëpërmjet angazhimeve online, të kërkojë mundësi për vetëzhvillimin dhe fuqizimin duke përdorur teknologjitë dhe mjediset digjitale, të jetë i vetëdijshëm për potencialin e teknologjive për pjesëmarrjen e qytetarëve.</li> <li>- <b><i>Bashkëpunimi ndërmjet kanaleve digjitale:</i></b> të përdorë teknologjitë dhe median për punën në</li> </ul>

<p>Kërkimi dhe gjetja e informacionit</p>	<p>grup, të bashkëpunojë në proceset e bashkëndërtimit dhe bashkëkrijimit të burimeve, njohurive dhe përmbajtjes.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Etika e komunikimit online:</b>të dijë dhe të njohë si janë rregullat e sjelljes online/ ndërveprimet virtuale, të jetë i vetëdijshëm për aspektet e diversitetit kulturor, të jetë i aftë të mbrojë veten dhe të tjerët nga rreziqet e mundshme online, të zhvillojë strategjitë aktive për të zbuluar sjelljet e papranueshme.</li> <li>- <b>Administrimi i identitetit digjital:</b> të krijojë, adaptojë dhe drejtojë një ose më shumë identitete digjitale, të jetë i aftë të mbrojë reputacionin e dikujt, të merret me të dhënat që ai prodhon përmes disa llogarive të aplikimeve.</li> </ul>
<p>Mendimi kritik, problem-zgjidhës dhe vendimmarrja</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Shfletosja, kërkimi dhe filtrimi i informacionit:</b> të hyjë dhe të kërkojë informacion online, të artikulojë nevojat informative, të gjejë informacionin e përshtatshëm, të zgjedhë burimet efektive, të lundrojë ndërmjet burimeve online, të krijojë strategji personale informacioni.</li> <li>- <b>Vlerësimi i informacionit:</b>të mbledhë, të përpunojë, të kuptojë dhe të vlerësojë në mënyrë kritike informacionin.</li> <li>- <b>Ruajtja dhe rigjetja e informacionit:</b>të ndryshojë dhe të ruajë informacionin dhe përmbajtjen për korrigjim më të lehtë, të organizojë informacione dhe të dhëna.</li> <li>- <b>Zgjidhja e problemeve teknike:</b> të gjejë problemet e mundshme dhe t'i zgjidhë ato (nga troubleshooting në zgjidhjen e problemeve më komplekse) me ndihmën e mjeteve digjitale.</li> <li>- <b>Gjetja e nevojave dhe përgjigjeve teknologjike:</b> të vlerësojë nevojat e veta në termat e burimeve, mjeteve dhe zhvillimit të kompetencave, të përshtasë nevojat me zgjidhjen e mundur, të përshtasë mjetet me nevojat personale, të vlerësojë në mënyrë kritike zgjidhjet e mundshme dhe mjetet digjitale.</li> <li>- <b>Gjetja e boshllëqeve të kompetencave digjitale:</b> të kuptojë kur kompetencat e veta nevojiten të përmirësohen ose të përditësohen, të mbështesë të tjerët në zhvillimin e kompetencave të tyre digjitale, të mbajë dhe të japë zhvillimet e reja.</li> </ul>
<p>Mbrojtja</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Mbrojtja e pajisjeve:</b> të mbrojë pajisjet e veta dhe të kuptojë rreziqet online dhe kërcënimet, të marrë njohuri rreth mbrojtjes dhe masave të sigurisë.</li> <li>- <b>Mbrojtja e të dhënave personale:</b> të kuptojë termat e zakonshme të shërbimit, të aktivizojë mbrojtjen e të dhënave personale, të kuptojë privatësinë e njerëzve të tjerë, të mbrojë veten nga mashtrimet në internet dhe kërcënimet.</li> <li>- <b>Mbrojtja e shëndetit:</b>të shmangë rrezikun e shëndetit që lidhet me përdorimin e teknologjisë në termat e kërcënimeve në të mirën e shëndetit fizik dhe psikologjik.</li> </ul>

### VIII. Koha mësimore për secilën klasë

Lënda e TIK-ut zhvillohet për 30 javë mësimore me nga 1 orë secila, pra gjithsej 30 orë për secilën klasë. Programi i lëndës së TIK-ut specifikon kohën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit bazë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

**Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë**

	Bota e kompjuterit	Përpunimi digjital i tekstit dhe analiza e të dhënave	Kërkimi në Web/Internet dhe e-maili	Botimet dhe siguria në internet	Prezantimi digjital	Gjithsej orë
<b>Shkalla e tretë</b>						60 orë
<b>Klasa e gjashtë</b>	4 orë	10 orë	8 orë	4 orë	4 orë	30 orë
<b>Klasa e shtatë</b>	3 orë	10 orë	3 orë	3 orë	11 orë	30 orë
<b>Shkalla katwrt</b>						
<b>Klasa 8-të</b>	5	7	7	6	5	30 orë
<b>Klasa 9-të</b>	7	6	6	5	6	30 orë

#### 8.1 Përmbajtja e shkallës së tretë

Në programin e fushës/lëndës së TIK-ut për shkallën e dytë janë paraqitur përmbajtjet e tematikave:

- *Bota e kompjuterit.*
- *Përpunimi digjital i tekstit dhe analiza e të dhënave.*
- *Kërkimi në Web/Internet dhe e-mail-i.*
- *Botimet dhe siguria ne internet.*
- *Prezantimi digjital.*

Këto tematika janë bazë për të ndërtuar njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera. Tematikat janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënës sipas kompetencave digjitale, për çdo shkallë të paraqitura në tabelë në fillim të çdo tematike. Për secilën tematikë, sipas klasave të shkallës janë paraqitur njohuritë për secilën klasë të shkallës. Aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse paraqiten vetëm në nivel shkalle për secilën shkallë.

Koha për secilën tematikë lidhet së pari me rëndësinë e tematikës dhe së dyti me shkallën e vështirësisë së saj për tu përvetësuar nga nxënësit.

Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Mësuesit janë të lirë të ndryshojnë me 10% (më shumë ose më pak) orët e rekomanduara për secilën tematikë. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, si dhe ndarjen e orëve sipas tematikave. Në programin e arsimit të mesëm të ulët mësuesit duhet të kenë në konsideratë që kjo lëndë duhet të bazohet në realizimin e aftësive që i duhen nxënësit për gjatë gjithë jetës. Që nxënësit të aftësohen në këtë lëndë ata duhet të kenë në dispozicion orë që ju mundësojnë praktikimin e njohurive të reja dhe infrastrukturën e përshtatshme në shkollë.

Mësuesit dhe hartuesit e teksteve janë të lirë t'i organizojnë kapitujt dhe renditjen e tyre, por ajo që është e rëndësishme dhe duhet marrë në konsideratë është se tematikat zgjasin përgjatë gjithë vitit shkollor dhe si e tillë kapitujt e teksteve nuk mund të jenë të ndarë por duhet të kenë ndërlidhje dhe vazhdimësi. Gjithashtu mësuesit duhet të marrin në konsideratë që situatat janë në qendër të zhvillimit të orës mësimore dhe nëpërmjet situatave të synohet arritja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve. Ndaj do të ishte dhe në ndihmë të mësuesit nëse tekstet do të ishin të pasura me situata praktike të janë të marra nga jeta e përditshme.

## IX. Shkalla e tretë

**SHKALLA E TRETË**  
**Klasa e gjashtë, klasa e shtatë**

<b>9.1 Tematika : Bota e kompjuterit</b>	
<p><b>Përshkrimi i tematikës:</b> Nxënësi është në gjendje të analizojë dhe interpretojë të dhëna statistikore nëpërmjet programeve të paketës <i>WindowsOffice</i>. Në këtë cikël synohet që nxënësi të zhvillojë aftësi, qëndrime dhe njohuri që do t'i nevojiten atij në jetën e përditshme, por edhe për ta aftësuar më shumë në përdorimin e thelluar të kompjuterit dhe internetit.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:</b></p> <p><i>Kreativiteti dhe inovacioni duke përdorur teknologjinë:</i> përdor kompjuterin për të zhvilluar të menduarit kreativ dhe konstruktiv apo për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin.</p> <p><i>Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:</i> vlerëson sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre në termat e mbledhjes së kërkesave, të rejave dhe qëndrueshmërisë.</p> <p><i>Operacionet baze dhe konceptet teknologjike:</i> Shpjegon se si sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre përmbushin nevojat duke marrë parasysh qëndrueshmërinë.</p>	
<b>Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës</b>	<b>Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës</b>
<p><b>NJOHURITË KLASA 6</b></p> <p><b>Bota e kompjuterit</b></p> <p><b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njohin më në detaje pjesët e kompjuterit dhe rolin e tyre në bashkërendimin e punës;</li> <li>• njohin ndryshimin e portave dhe kabllove të pajisjeve të jashtme (tastiera, <i>mausi</i>, USB, bokset audio,</li> </ul>	<p><b>Bota e kompjuterit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Heton komponentët kryesorë të zakonshëm të sistemeve digjitale, funksionet bazë të tyre si dhe</li> </ul>

<p>ekrani, porta HMDI (për lidhje video dhe DVD), porta VGA për lidhjen me ekranin ose me video projektor.</p>	<p>ndërveprimet dhe se si këto sisteme mund të lidhen së bashku për të krijuar një rrjet dhe për të transmetuar të dhënave.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcakton problemet në termat e të dhënave dhe kërkesave funksionale dhe identifikon karakteristikat e ngjashme me problemet e zgjidhura më parë.</li> <li>- Harton një ndërfaqe të përdoruesit për një sistem digjital duke krijuar dhe duke pasur parasysh dizajnët alternative.</li> </ul>
<p><b>NJOHURITË KLASA 7</b></p> <p><b>Bota e kompjuterit</b></p> <p><b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdorin programet e mbrojtjes kundër viruseve në kompjuter;</li> <li>• kryejnë përditësimin e antivirusëve;</li> <li>• përshkruajnë problemet që mund t’u lindin gjatë punës në kompjuter në nivelin <i>Hardware</i> ose <i>Software</i>;</li> <li>• kryejnë hapjen deri në tri dritare në <i>desktop</i> dhe punojnë njëkohësisht me to;</li> <li>• ç’instalojnë programet nga skedari i <i>Software</i> dhe shkarkojnë një program më të përditësuar;</li> </ul>	
<p><b>Qëndrime dhe vlera:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Është i përgjegjshëm gjatë përdorimit të mjeteve teknologjike.</li> <li>- Kupton karakteristikat, tiparet dhe shfrytëzimin e mjediseve elektronike për bashkëpunim.</li> <li>- Kuptojnë përdorimin e komponentëve standard të hyrjes, përpunimit, ruajtjes dhe daljes si: hyrje-tastierë, mikrofon; përpunim-njësia qendrore e përpunimit; dalje-monitor, folësit, projektor, <i>storage-cloud USB, Hard-drive</i>.</li> <li>- Kuptojnë përdorimin dhe rolin e sistemit dhe aplikimit <i>software</i>.</li> <li>- Është i vetëdijshëm për rëndësinë e <i>back-up-it</i>.</li> <li>- Është i vetëdijshëm për pasojat kur një përmbajtje e ruajtur është private apo publike.</li> <li>- Është i gatshëm të ndajë dhe të bashkëpunojë me të tjerët.</li> </ul>	

- Është i gatshëm të jetë pjesë e ekipit.
- Merr pjesë aktive në zgjidhjen e problemit.
- Është i gatshëm të kërkojë këshilla kur shfaqet një problem.
- Mendon alternativat kur problemet nuk janë zgjidhur .

**Veprimtaritë e sugjeruara:**

Mësues-i/ja tregon në laborator pjesët e kompjuterit, të cilat pas shpjegimit ua lë nxënësve për t'i montuar. Nxënësve u ofrohet edhe trajnim për seanca aktivitete, ku do të ketë prezantim.

**9.2 Tematika: Përpunimi digjital i tekstit dhe analiza e të dhënave**

**Përshkrimi i tematikës:** Nxënësi është në gjendje të analizojë dhe interpretojë të dhëna statistikore nëpërmjet programeve të paketës *WindowsOffice*. Në këtë cikël synohet që nxënësi të zhvillojë aftësi, qëndrime dhe njohuri që do t'i nevojiten atij në jetën e përditshme, por edhe për ta aftësuar më shumë në përdorimin e thelluar të kompjuterit dhe internetit.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:**

*Kreativiteti dhe inovacioni:* planifikon dhe menaxhon projekte digjitale për të krijuar informacion interaktiv. Korrigjon tekstet nga ana ortografike duke përdorur fjalorin elektronik si dhe e formaton sipas modelit të kërkuar.

*Kërkimi dhe gjetja e informacionit:* analizon dhe vlerëson të dhëna nga një sërë burimesh për të modeluar dhe krijuar zgjidhje

*Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:* përfshijnë marrjen e vendimeve përsëritjen dhe ndërfaqen e projektuar të përdorur dhe implementojnë zgjidhjet e tyre digjitale duke përfshirë programet vizuale.

*Operacionet bazë dhe konceptet teknologjike:* kupton dhe përdor saktë sistemet e teknologjisë; përzgjedh dhe përdor aplikacionet në mënyrë efektive dhe produktive; zgjidh problemet e sistemeve dhe e aplikacioneve; njohuritë e fituara i vë në funksion të mësimin të teknologjive të reja.

<p><b>Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës</b></p>	<p><b>Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës</b></p>
<p><b>NJOHURITË KLASA 6</b></p> <p><b>Përpunimi digjital i tekstit</b></p> <p><b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shkruajnë, selektojnë, fshijnë dhe printojnë tekste;</li> </ul>	<p><b>Përpunimi digjital i tekstit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Heton se si të dhënat transmetohen dhe sigurohen në rrjetet Wireless, mobile dhe si specifikimet e</li> </ul>

- kërkojnë në tekst, ndryshojnë dhe zëvendësojnë gërmat ose fjalët;
- shtojnë simbole të veçanta që mund t'i përdorin në lëndë të ndryshme, si p.sh.: (shkrimi me gërma romake në histori...);
- përdorin funksionet kryesore të programeve të shkrimit (p.sh. format e formatimit të tekstit, faqes etj.);
- njohin formatimet e ndryshme të rreshtave dhe të simboleve;
- dinë të formatojnë paragrafët, përdorin rregullat sintaksore të të shkruarit në *Word*, arrijnë t'i gjejnë lehtë gabimet ortografike dhe t'i korrigjojnë ato;
- shkruajnë tekste me llojin e formatimit të paradhënë;
- ndërtojnë dhe formatizojnë një tabelë të re (ndryshojnë ngjyrat e rreshtave, trashësinë e vijës, tabela të jetë brenda formatit A4 dhe të formatizojnë tekstin e tabelës);
- krijojnë lista me numra dhe numërime;
- njohin shumëllojshmërinë e opsioneve të përdorimit të tabelave;
- mësojnë të hedhin të dhënat sipas metodave të ndryshme nga burime të ndryshme (linqe nga interneti, dokumente të skanuara, fotografi të ruajtura, dokumente nga browser i kompjuterit);

**Analiza e të dhënave (p.sh. *Excel*): Mund të zgjidhen opsione të tjera**

- njohin ikonat kryesore dhe të thjeshta të *excel*-it, të cilat mund të kuptohen në këtë klasë dhe janë të ngjashme me ato të *word*-it;
- hedhin shifrat në një libër ose fletë pune të programeve, si *microsoft excel* (ose *openoffice calculators*);
- praktikojnë “praktikat efektive”, si p.sh.: shmangien e qelizave boshe, formatimin e

komponentëve hardware ndikojnë në rrjetin e aktiviteteve.

- Merr të dhëna nga një sërë burimesh dhe vlerëson origjinalitetin saktësinë dhe afatet kohore.
- Analizon dhe paraqet të dhëna duke përdorur një sërë programesh për të krijuar informacion dhe përdor të dhënat e strukturuar për të modeluar objekte ose ngjarje.
- Harton eksperiencën e përdoruesit të një sistemi digjital, gjenerimin, vlerësimin dhe planet alternative të komunikimit.
- Vlerëson se sa mirë janë zhvilluar zgjidhjet dhe janë përmbushur nevojat ekzistuese të sistemeve të informacionit , të rejtat dhe marrin parasysh rreziqet dhe qëndrueshmërinë në të ardhmen.
- Heton se si sistemet digjitale paraqesin tekst, imazh dhe audio të dhëna binare.
- Zbaton zgjidhje digjitale si programe të thjeshta vizuale që përfshijnë degëzime, përsëritje dhe të dhëna përdoruesi.
- Merr, ruan dhe vlerëson lloje të ndryshme t--dhe --



<p>përmbajtjeve (p.sh.: të ndajë në qeliza të veçanta emrin dhe mbiemrin);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdorin ikonën për të renditur të dhënat nga A në Z;</li> <li>• kuptojnë rëndësinë e shkrimit të numrave në formë të njëtrajtshme në <i>excel</i>;</li> <li>• përdorin ikonën për gjetjen e shumës në një kolonë;</li> <li>• formatojnë përmbajtjen e qelizave dhe hedhjen e tyre në një tabelë;</li> <li>• llogarisin të dhënat e disa qelizave sipas formulave të thjeshta;</li> <li>• krijojnë një diagram në formë rrethi, duke u bazuar te të dhënat e gjetura.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor një sërë software-sh të zakonshëm për të interpretuar dhe kujtuar të dhënat në kontekst për të krijuar informacion.</li> <li>- Planifikon dhe menaxhon projekte duke përfshirë detyra, kohë dhe burime të tjera të nevojshme duke marrë parasysh sigurinë dhe qëndrueshmërinë.</li> <li>- Në mënyrë të pavarur zbaton strategjitë për përcaktimin e llojit të duhur të informacionit digjital të përshtatshëm për ruajtjen e vendndodhjes dhe sigurinë për mjediset online.</li> <li>- Përdor një gamë të TIK-ut për identifikimin dhe paraqitjen në grupe të informacionit dhe paraqet pyetje për të ndjekur kërkimin ose gjenerimin për informacionin e mëtejshëm.</li> <li>- Vlerëson përshtatshmërinë e të dhënave ose informacionin duke pasur parasysh kriteret e përshtatshme.</li> <li>- Përdor TIK-un e duhur për të gjeneruar ide bashkërisht dhe zhvillojnë plane.</li> <li>- Drejton dhe mban të dhëna në servera të ndryshëm .</li> </ul>
<p><b>NJOHURITË KLASA 7</b></p> <p><b>Përpunimi digjital i tekstit</b></p> <p><b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdorin funksionet kryesore të programeve të shkrimit (<i>p.sh. format e formatimit të tekstit, faqes etj.</i>), në mënyrë që të dinë të shkruajnë qartë dhe saktë një detyrë shtëpie;</li> <li>• dallojnë pjesët e tekstit ose të grafikës që fshihen ose nuk printohen;</li> <li>• përzgjedhin opsionin print preview para printimit të tekstit për të kuptuar cilësinë e printimit;</li> <li>• përzgjedhin opsionet: printim me ngjyra, printim bardhezi, të zgjedhin formatin e fletës, printojnë dy faqe në një, dinë të përdorin opsionin për të printuar para dhe prapa faqes;</li> <li>• mirëmenaxhojnë printimin për të kursyer bojën;</li> <li>• rregullojnë problemet që mund të lindin gjatë printimit, p.sh., nëse i bllokohet një faqe, dinë ta nxjerrin nga printeri, kuptojnë kur mbaron boja e printerit dhe dinë të vendosin një të re.</li> <li>• vendosin, pozicionojnë dhe ngjisin grafikë e fotografi;</li> <li>• ndryshojnë opsionet (të dhënat bazë) e grafikëve;</li> <li>• futin të dhëna të gatshme që gjenden në ikonat e <i>word</i>-it, si: imazhe, fjalë, sinonime;</li> <li>• gjejnë shumëllojshmëri fjalësh nëpërmjet ikonës <i>research</i> në <i>word</i>;</li> <li>• përdorin ikonën <i>clip art</i> për të integruar imazhe sipas fjalëve;</li> </ul>	

- shtojnë *header* and *footer* në një tekst të shkruar;
- kuptojnë rëndësinë e përdorimit të header dhe footer për dokumente të rëndësishme;
- përdorin *page break* për kalimin në një faqe të re.

#### **Përpunimi digjital i imazheve**

- përpunojnë fotografitë: t'i presin, t'i rrotullojnë, t'u ndryshojnë ngjyrat dhe madhësitë, t'i transferojnë, t'i ruajnë në një dosje në formatin e dëshiruar.

#### **Analiza e të dhënave (*excel*)**

- përlllogaritin përmbajtjen e një qelize me anën e formulave;
- lexojnë gabimet që mund të dalin gjatë llogaritjes së qelizave në *excel*;
- formatojnë dhe ndryshojnë të dhënat e një diagrame;

#### **Qëndrime dhe vlera:**

- Ka qëndrim aktiv drejt kërkimit të informacionit
- Vlerëson aspektet pozitive të teknologjive për korrigjimin e informacionit.
- Është i motivuar të kërkojë informacion për aspekte të ndryshme të jetës së tij/asaj.
- Është kurioz rreth sistemeve të informimit dhe funksioneve të tyre.
- Arsyeton që jo i gjithë informacioni mund të merret në internet.
- Është kritik ndaj informacionit të gjetur.
- Është i vetëdijshëm pavarësisht globalizimit të vendeve të caktuara që janë më të pranishme në internet.

#### **Veprimtaritë e sugjeruara**

- Zgjedhin *software* specifik grafik ose mjete grafike në *word processor* duke përdorur printer, skaner, server, kamera digjitale etj.
- Ruajnë/eksportojnë të dhëna në dosje të formateve të ndryshme; procesi rutinë *back-up* dhe mbrojtja e të dhënave; transportimi i të dhënave nga një vend në tjetrin.
- Nxënësit mund të realizojnë me një tabelë të thjeshtë orarin e tyre javor, ku të vendosin përqindjen (%) e orëve mësimore, por edhe ta modifikojnë tabelën. Alternativë do të ishte një listë me emrat e nxënësve të klasës për ekskursion ose një listë notash ose për blerje etj.

- Mësojnë historinë bazë të shtypshkrimit, duke përfshirë qëllimin e *Shrift*-it dhe pse u sfiduan në fillimet e shekullit XX. Nxënësit do të bëjnë dallimin mes shtypshkrimit me dhe pa *Shrift*. Kuptojnë dallimin mes përgatitjes së dokumentit për rezultate digjitale dhe printimi.
- Përdorin menu dhe komanda për të ripunuar përmbajtjen dhe strukturën e dokumentit.
- Krijojnë një database në klasë të cilin mund ta përdorin për të kuptuar më mirë formulat e matematikës dhe se si këto formula aplikohen në *Excel*.

### 9. 3 Tematika: Kërkimi në web/internet dhe e-mail-i

**Përshkrimi i tematikës:** Nxënësi shkruan dhe hap linqe nëpërmjet faqeve kërkuese. Di të navigojë nëpër faqet e internetit, përdor lehtësisht internetin ose burime të tjera elektronike për kërkim informacioni. Gjithashtu ruan dhe shkarkon informacione në një server online.

Nxënësit njohin specifikimet e motorëve të kërkimit dhe janë në gjendje të kërkojnë informacione në portale të ndryshme elektronike. Ata njohin dhe përdorin në mënyrë të saktë mjetet mediatike, si dhe funksionin dhe rolin e secilit mjet.

#### Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

*Komunikimi dhe bashkëpunimi:* përdor protokolle të miratuara kur komunikon dhe bashkëpunon online.

*Kërkimi dhe gjetja e informacionit:* përcakton/vendos strategjinë e kërkimit të informacionit; gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe mediave; përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë e tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave (apo problemeve të veçanta); përpunon të dhënat dhe raporton rezultatet; përdor informacionin e fituar për punë të pavarur duke iu referuar edhe te drejtave të autorit.

#### Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës

##### NJOHURITË KLASA 6

##### Kërkimi në web/internet

##### Nxënësit:

- regjistrohen, hyjnë dhe dalin nga akaunti në platformat në internet;
- bëjnë dallimin midis *web-browse* të ndryshme (*Internet Explorer, Mozilla, Google Chrome*);
- njohin dhe ndryshojnë opsionet e *web-browse* (paracaktimin e ruajtjes dhe shkarkimit të

#### Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës

##### Kërkimi në web/internet

- Krijon dhe komunikon ide dhe informacione interaktive bashkërisht online duke marrë parasysh kontekstin social.
- Zbaton praktika që përputhen me

dokumenteve, instalimin e shtesave);

- njohin opsionet specifike të motorëve të kërkimit, si p.sh., Google kur ata kërkojnë një informacion (sipas gërmave, një fraze, gjuhës, llojit të dokumenti, kohës dhe vendit të botimit, të drejtave të autorit...);
- skicojnë strukturën e internetit dhe njohin mënyrën si të kërkojnë dokumente në portale të ndryshme;

#### ***e-mail-i dhe chat-i***

- dallojnë *e-mail*-et spiune ose të padëshiruara si ato SPAM dhe i ruajnë (bazuar në rregullat e mbrojtjes nga interneti dhe platforma e vetë *e-mail-it* ose të programit të *e-mail-it*);
- kuptojnë se kompjuteri mund të infektohet me virus nëse hapim *e-mail*-e ose nëse shkarkojmë dokumente nga dërgues të panjohur;
- njohin madhësinë e dokumentit kur e dërgojnë në bazë të kufizimit të vendosur nga *provideri* i *e-mail-it*;
- kuptojnë stilin e të shkruarit dhe të jenë të vetëdijshëm për ndikimin të marrësi.

#### **Përdorimi i mjeteve mediatike**

- përdorin një aparat fotografik dhe shkarkojnë në kompjuter të gjitha fotografitë;
- ruajnë fotografitë dhe dinë t'i transferojë në CD ose USB;
- përpunojnë fotografitë (me programin *PAINT*, *MS Office Picture manager*);

### **NJOHURITË KLASA 7**

#### **Kërkimi në web/internet dhe e-mail-i**

##### **Nxënësit:**

- kërkojnë nëpërmjet programeve kërkuese dhe e përpunojnë materialin pasi e kanë gjetur;
- shënojnë faqet e tyre të preferuara gjatë punës në internet për t'i hapur më lehtë kur u nevojiten (*bookmarks* dhe *favorites*);
- menaxhojnë librin e adresave të kontakteve në *e-mail*.

detyrimet ligjore që kanë të bëjnë me pronësinë dhe përdorimin e produkteve dhe burimeve digjitale.

- Lokalizon, rigjen ose gjeneron informacionin duke përdorur motorët e kërkimit ose funksionet e thjeshtë të kërkimit dhe klasifikon informacionin në mënyra kuptimplote.
- Në mënyrë të pavarur ose bashkërisht krijojnë dhe modifikojnë zgjidhjet digjitale rezultatet ose të dhënat krijuese përfaqësimi/transformimi për audienca dhe qëllime të veçanta.
- Zgjedh dhe përdor mjetin TIK të përshtatshëm për të ndarë dhe shkëmbyer informacione dhe të bashkëpunojë me të tjerët në mënyrë të sigurtë .

### **Qëndrime dhe vlera:**

- Është i sigurt dhe i qetë gjatë komunikimit dhe shprehjes nëpërmjet mediave digjitale.
- Është i vetëdijshëm për kodin e mirësjelljes në përshtatje me kontekstin.
- Është i vetëdijshëm për rrezikun lidhur me komunikimin online me persona të panjohur.
- Angazhohet në mënyrë aktive në komunikimin online.
- Është i gatshëm të zgjedhë mjetet më të përshtatshme të komunikimit sipas qëllimit.
- Merr qëndrim aktiv në shpërndarjen e burimeve, përmbajtjes dhe njohurive.
- Ka opinionin e vet të informimit rreth shpërndarjes së praktikave, përfitimeve, rreziqeve dhe kufizimeve.
- Pranon dhe vlerëson diversitetin.
- Ka qëndrim të sigurt dhe të ndjeshëm në aktivitetet digjitale.
- Ka një opinion të informimit të autorizimit të praktikave.
- Është i vetëdijshëm për çështjet e së drejtës së autorit.
- Është i vetëdijshëm për potencialin e teknologjive dhe mediave për pjesëmarrje.
- Kë një arsytim kritik të medias sociale, rrjeteve dhe komunikimeve online.
- Angazhohet me pjesëmarrje në media.

### **Veprimtaritë e sugjeruara**

- Nxënësit krahasojnë *webbrowserat* për ngjashmëritë dhe dallimet. Ato i instalojnë dhe i çinstalojnë ato.
- Nxënësit analizojë kërkimin e rezultateve të motorit për të bërë dallimin mes rangjeve të kërkimit të fituar me pagesë. Kuptojnë komponentët e një kërkimi të përputhur.
- Si detyrë ato kanë mbledhjen e informacionit mbi një godinë të njohur në qytet. Kërkimet realizohen te faqja zyrtare dhe në forume në internet. Pastaj bëhen krahasimet.
- Krahasim mes MS Word dhe *Open Office*
- Mësues-i/ja shpjegon se çfarë është SPAM-i, tregon komandën për ndallimin e tyre.

(Mund të përdoren filma me metrazh të shkurtër për sensibilizim.) Më pas, një kuiz për sigurinë në internet dhe (anti) viruset.

Nxënësit (nën kujdesin e mësues-it/es) i shkruajnë letër shokut/shoqes dhe drejtorit ose teknikut të shkollës për (gjoja problemin e kompjuterit, i cili ka virus). Të dallohet gjuha e përdorur.

- Ruajtja e fotove dhe e videove të aktivitetit shkollor në kompjuter. Menaxhimi, riemërimi dhe ruajtja në CD, shumëfishimi i tyre për t'u shpërndarë nxënësve.
- Bazuar në një temë të dhënë nga mësuesi i klasës, nxënësit do të nxjerrin përfundime të ilustruara me prova eksperte specifike. Nxënësit do të japin cilësime (attribute) në formë kllapash.

#### 9.4 Tematika: Botimet dhe siguria në internet

**Përshkrimi i tematikës:** Nxënësi njihet me rreziqet që vijnë nga përdorimi i faqeve të web-it, të cilat nuk ofrojnë siguri të lartë për të dhe nuk publikojnë të dhëna personale që çenojnë sigurinë e tyre personale, duke e demonstruar përmes veprimeve nevojën për realizimin e tij në shtëpi, komunitet dhe shkollë, sipas rregullave të sigurta

#### Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

- **Shfletosja, kërkimi dhe filtrimi i informacionit:** të hyjë dhe të kërkojë informacion online, të artikulojë nevojat informative, të gjejë informacionin e përshtatshëm, të zgjedhë burimet efektive, të lundrojë ndërmjet burimeve online, të krijojë strategji personale informacioni.
- **Vlerësimi i informacionit:** të mbledhë, të përpunojë, të kuptojë dhe të vlerësojë në mënyrë kritike informacionin.
- **Ruajtja dhe rigjetja e informacionit:** të ndryshojë dhe të ruajë informacionin dhe përmbajtjen për korrigjim më të lehtë, të organizojë informacione dhe të dhëna.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
<b>NJOHURITË KLASA 6</b> <b>Botimet dhe siguria në internet</b> <b>Nxënësit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njohin problemet që mund të lindin kur ata komunikojnë në rrjete sociale;</li> </ul>	<b>Siguria në internet</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbron veten dhe të tjerët nga kërcënimet online.</li> <li>- Ndalon dhe raporton abuzimet dhe</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• dallojnë profilet reale dhe serioze të krijuara në rrjete sociale (nxënësit mund të jenë pre e manipulimeve të më të rriturve që i përdorin këto rrjete sociale në formë jo të përshtatshme);</li> <li>• njohin rreziqet e blerjes së CD-ve pa të drejtën e autorit ose të shkarkimit të filmave, këngëve nga <i>website</i> pirate;</li> <li>• kuptojnë rëndësinë e mbylljes (<i>log out</i>) të adresave personale (e-mail, blogje, forume, rrjete sociale), nëse i hapin ato në vende publike.</li> </ul>	<p>kërcënimet.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillon strategjitë për trajtimin e ngacmimit kibernetik dhe për zbulimin e sjelljes së përshtatshme.</li> <li>- Përdor shërbimet digjitale pa krijuar varësi nga ato.</li> <li>- Di si t'i përdorë pajisjet digjitale efikase në kosto dhe në kohë.</li> </ul>
<p><b>NJOHURITË KLASA 7</b></p> <p><b>Botimet dhe siguria në internet</b></p> <p><b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• botojnë fotografi dhe tekste në një blog apo <i>Wiki</i> interneti;</li> <li>• nuk publikojnë foto që nuk janë të tyre pa marrë aprovimin e personazhit të gjendur në foto;</li> <li>• nuk publikojnë foto që çenojnë personalitetin e shokëve dhe të afërmve;</li> <li>• analizojnë vërtetësinë e informacioneve në bazë të kritereve të paracaktuara.</li> </ul>	
<p><b>Qëndrime dhe vlera:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Konsideron parimet etike të përdorimit dhe publikimit të informacionit.</li> <li>- Ka ndjenjë të përparuar të sjelljes së përshtatshme në lidhje me kontekstin e mediave, audiencën dhe dispozitat ligjore.</li> <li>- Shfaq fleksibilitet dhe përshtatje me kulturat e ndryshme të komunikimit digjital.</li> <li>- Mban qëndrim pozitiv, por realist në lidhje me të mirat dhe rreziqet që shoqërojnë teknologjitë e informacionit.</li> <li>- Kupton që mjedisi digjital ku përballet mund të bëjë gjëra të mira dhe të këqija; varet nga ajo se si ne e përdorim atë dhe çfarë rregullash gjejmë për atë.</li> <li>- Është i vetëdijshëm lidhur me çështjet mjedisore gjatë përdorimit të teknologjive digjitale.</li> </ul>	
<p><b>Veprimtaritë e sugjeruara:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit listojnë të gjitha burimet, emrat e autorëve, URL-në e informacionit që ata përdorin</li> <li>- Nxënësit nuk ruajnë informacionin privat në faqet publike në internet, vendosin akses përdoruesi dhe parametrat e privatësisë.</li> </ul>	

- Nxënësit kuptojnë rrezikun e dhënies së informacionit personal, njohjen dhe raportimin e krimeve kibernetike, postojnë një foto me lejen e pronarit, nuk zbulojnë detaje të identitetit, shmangin ofensivën e gjuhës së papërshtatshme të disa grupe njerëzish.

## 9.5 Tematika: Prezantimi digjital

**Përshkrimi i tematikës:** Nxënësi njihet me rreziqet që vijnë nga përdorimi i faqeve të *web-it*, të cilat nuk ofrojnë siguri të lartë për të dhe nuk publikojnë të dhëna personale që çenojnë sigurinë e tyre personale, duke e demonstruar përmes veprimeve nevojën për realizimin e tij në shtëpi, komunitet dhe shkollë, sipas rregullave të sigurta

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

**Komunikimi dhe bashkëpunimi:** ndërvepron, bashkëpunon dhe publikon me moshatarët në mënyrë të sigurt online, zhvillon vetëdijen/ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e sigurisë online duke bashkëpunuar me moshatarët e tjerë; kontribuon në rritjen e rendimentit të punës në grupet e projekteve për të sjellë produkte origjinale apo për të zgjidhur problemet; ruan etikën e komunikimit personal dhe atë të grupit; përdor mjete të shumëllojshme .

**Kërkimi dhe gjetja e informacionit:** përcakton/vendos strategjinë e kërkimit të informacionit; gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe mediave; përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave (apo problemeve të veçanta); përpunon të dhënat dhe raporton rezultatet; përdor informacionin e fituar për punë të pavarur duke iu referuar edhe te drejtave të autorit.

**Operacionet bazë dhe konceptet teknologjike:** kupton dhe përdor saktë sistemet e teknologjisë; mbron pajisjet e veta dhe kupton rrezikun online dhe kërcënimet; zgjidh problemet e sistemeve dhe të aplikacioneve; njohuritë e fituara i vë në funksion të mësimit të teknologjive të reja.

### Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës

### Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës

#### NJOHURITË KLASA 6

Mësuesit angazhojnë nxënësit të zhvillojnë nëpërmjet prezantimeve multimediale, të gjitha projektet kurrikulare me bazë fushe apo shkolle.

#### Nxënësit:

- njohin parimet bazë të power-point-it;
- përdorin programin paint për të realizuar postera të thjeshtë;

#### Prezantimi digjital power point

- Përdor sistemet digjitale për të vërtetuar të dhënat p.sh. vendosja e llojeve të të dhënave në një spreadsheet për t'u siguruar që një e dhënë është



<ul style="list-style-type: none"> <li>• dinë të bëjnë një prezantim të thjeshtë duke ndarë paragrafët dhe duke vendosur një titull prezantimi;</li> <li>• përdorin <i>word art</i>, për të ndryshuar shkrimin në word;</li> <li>• janë në gjendje të bëjnë <i>cut</i> dhe <i>paste</i>, figurave dhe imazheve të gjetura në motorët e kërkimi.</li> </ul>	<p>futur saktë.</p> <p>- Paraqesin dhe komunikojnë idetë e hartuara duke përdorur standardet e modelimit dhe dizenjimit duke përfshirë teknologjitë digjitale p.sh. simbolet dhe kodet në diagram, hartat e ilustruara, pamjet ajrore duke përdorur aplikacionet e shërbimit web të hartave.</p>
<p><b>NJOHURITË KLASA 7</b></p> <p><b>Prezantimi digjital PowerPoint</b></p> <p><b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dallojnë ikonat bazë të <i>powerpoint</i> që janë të ngjashme me ato të programit <i>microsoft word</i>;</li> <li>• krijojnë faqe të re dhe dinë të ndryshojnë rendin e tyre;</li> <li>• përpunojnë tekstin, krijojnë dhe përpunojnë faqe prezantimi me anën e programeve të prezantimit, si <i>microsoft powerpoint</i>;</li> <li>• ndryshojnë dizajnin e <i>slideve</i> që janë të gatshme në <i>powerpoint</i>;</li> <li>• përdorin <i>animation</i>;</li> <li>• përdorin <i>slide show</i> për prezantimin;</li> <li>• prezantojnë nga kompjuteri dhe e shfaqin me anën e projektorit;</li> <li>• përdorin saktësisht projektorit;</li> <li>• konfigurojnë laptopin me projektorin (nëpërmjet Ctrl+ F5 ose Ctrl + F8);</li> <li>• përshtasin përmasat e ekranit të laptopit, nëse projektori kërkon përmasa specifike;</li> <li>• ruajnë prezantimin në formate të ndryshme;</li> <li>• përdorin skedarët ekzistues të përpunuesit të fjalës, në mënyrë që ata të importojnë, figura fotosh</li> </ul>	
<p><b>Qëndrime dhe vlera:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Konsideron parimet etike të përdorimit dhe publikimit të informacionit.</li> <li>- Ka ndjenjë të përparuar të sjelljes së përshtatshme në lidhje me kontekstin e mediave, audiencën dhe dispozitat ligjore.</li> <li>- Shfaq fleksibilitet dhe përshtatje me kulturat e ndryshme të komunikimit digjital.</li> <li>- Mban qëndrim pozitiv por realist në lidhje me të mirat dhe rreziqet që shoqërohen teknologjitë e informacionit.</li> </ul>	

- Kupton që mjedisi digjital ku përballen mund të bëjë gjëra të mira dhe të këqija ; varet nga ajo se si ne e përdorim atë dhe çfarë rregullash gjejmë për atë.
- Është i vetëdijshëm lidhur me çështjet mjedisore gjatë përdorimit të teknologjive digjitale.

#### **Veprimtaritë e sugjeruara**

- Krijojnë prezantim *powerpoint* vetëm me tekst me përmbajtje që vetëzhvillohet.
- Eksperimentojnë më opsione të ndryshme që përfshijnë udhëzime të përsëritura p.sh. një *slideshow* vazhdimisht i përsëritur, një lëvizje e përsëritur në një animacion, një llogaritje e përsëritur në një spreadsheet.
- Krijimi i një kuiz-i ku pyetjet janë të përsëritura deri në përgjigjen e saktë.
- Eksperimentojnë me hyrje shtesë të dhënash duke përfshirë import skedarësh, shkarkim figurash të fotografive nga kamera dhe skedarë PDF.

## **X. Programi i shkallës së 4-rt: klasa e 8-të dhe e 9-të**

### **SHKALLA E KATERT** **Klasa e tetë, klasa e nëntë**

#### **10.1 Tematika : Bota e kompjuterit**

**Përshkrimi i Tematikës:** Nxënësi është në gjendje të analizojë dhe interpretojë të dhëna statistikore nëpërmjet programeve të paketës Windows Office. Në këtë cikël synohet që nxënësi të zhvillojë aftësi, qëndrime dhe njohuri që do t'i nevojiten atij në jetën e përditshme, por edhe për ta aftësuar më shumë në përdorimin e thelluar të kompjuterit dhe internetit.

Nëpërmjet gjuhës së thjeshtë të programimit pritet që nxënësit të njihen me koncepte të programimit dhe të mjedisit Scratch dhe t'i zbatojnë ato gjatë realizimit të detyrave ose projekteve kurrikulare.

#### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:**

*Kreativiteti dhe inovacioni duke përdorur teknologjinë:* përdor kompjuterin për të zhvilluar të menduarit kreativ dhe konstruktiv apo për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin.

*Komunikimi dhe bashkëpunimi:* ndërvepron, bashkëpunon dhe publikon me moshatarët, ekspertët apo të tjerët duke përdorur kompjuterin;

përdor media dhe formate të ndryshme për komunikimin e informacionit dhe ideve në mënyrë efektive për audiencë të shumta;  
*Kërkimi dhe gjetja e informacionit:* përcakton strategjinë e kërkimit të informacionit; duke përdorur kompjuterin gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe mediave; përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave  
*Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:* vlerëson sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre në termat e mbledhjes së kërkesave, të reja dhe qëndrueshmërisë.  
*Operacionet baze dhe konceptet teknologjike:* Shpjegon se si sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre përmbushin nevojat duke marrë parasysh qëndrueshmërinë.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
<p><b>NJOHURITË KLASA 8</b></p> <p><b>Bota e kompjuterit</b></p> <p><b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njohin termin e autenticitetit të dokumentacionit dhe dinë se si e ku ta shpërndajnë informacionin e gjetur;</li> <li>• ruajnë me fjalëkalim fotot dhe informacionet e kompjuterit të tyre;</li> <li>• kompresojnë një bashkësi dokumentesh nëpërmjet programeve të posaçme: p.sh., WIN RAR dhe WIN ZIP;</li> <li>• instalojnë <i>driverat</i> nga CD-të e bashkëngjitura me objektin që duan të lidhim me kompjuterin (kamera, aparat fotografik, celular etj.).</li> <li>• njohin mënyrat e regjistrimit të sekuencave të shkurtra filmike dhe të transferimit të tyre në kompjuter.</li> </ul>	<p><b>Bota e kompjuterit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Merr të dhëna nga disa burime dhe vlerëson origjinalitetin, saktësinë dhe afatet kohore.</li> <li>- Analizon dhe parashikon të dhënat duke përdorur disa programe për të krijuar informacionin dhe përdor të dhëna të strukturuar për të krijuar projekte të veçanta.</li> <li>- Harton përdorimin e eksperiencës së një sistemi digjital, për të prodhuar, vlerësuar dhe komunikuar projekte alternative.</li> <li>- Zbaton dhe modifikon programe duke përdorur ndërfaqe që</li> </ul>

përfshijnë degëzime, përsëritje dhe funksione me një qëllim të përgjithshëm gjuhë programimi.

#### **Qëndrime dhe vlera:**

- Është i përgjegjshëm gjatë përdorimit të mjeteve teknologjike.
- Kupton karakteristikat, tiparet dhe shfrytëzimin e mjediseve elektronike për bashkëpunim.
- Kuptojnë përdorimin e komponentëve standard të hyrjes, përpunimit, ruajtjes dhe daljes si: hyrje-tastierë, mikrofon; përpunim-njësia qendrore e përpunimit; dalje-monitor, folësit, projektor, storage-cloud USB, Hard-drive.
- Kuptojnë përdorimin dhe rolin e sistemit dhe aplikimit software.
- Është i vetëdijshëm për rëndësinë e back-up.
- Është i vetëdijshëm për pasojat kur një përmbajtje e ruajtur është private apo publike.
- Është i gatshëm të ndajë dhe të bashkëpunojë me të tjerët.
- Është i gatshëm të jetë pjesë e ekipit.
- Merr pjesë aktive në zgjidhjen e problemit.
- Është i gatshëm të kërkojë këshilla kur shfaqet një problem.
- Mendon alternativat kur problemet nuk janë zgjidhur .

#### **Veprimtaritë e sugjeruara:**

- Diskutime në grup për zgjedhjen e strategjisë se ku dhe sa herë do të bëhet magazinimi i të dhënave: në partitionin e ri, memorien e jashtme (usb, hard disk) ose në internet (cloud).
- Me ndihmën e mësuesit/es bëhet përzgjedhja e programit Free ose Open Source të përshtatshme për lehtësimin dhe automatizimin e backup-it.

- Projektet aktuale të nxënësve ruhen në kopje rezervë të ndara në dosjet përkatëse, të cilat kompresohen dhe shpërndahen me e-mail.
- Printimi i produkteve të projektit në klasë me një printer të ri, për të cilin drajverat instalohen nga CD-ja ose shkarkohen nga faqja zyrtare në internet (duke marrë parasysh firmën prodhuese, numrin e serisë ose emrin e printerit dhe sistemin e kompjuterit).
- Formatimi i kompjuterit, instalimi dhe radhitja, njohja dhe krahasimi i sistemeve operative *Linux me Windows* në një kompjuter ose laptop.
- Diskutim mbi rolin dhe zhvillimin e kompjuterit në jetën e përditshme. Analizë e varësisë nga kompjuteri.
- Avantazhet dhe disavantazhet në fushat e komunikimit, teknologjisë, sociologjisë, shëndetit etj.
- Prezantimi i koncepteve të programimit dhe të mjedisit të Scratch , prezantimi i shembujve të ndryshëm të projekteve në Scratch.
- Rishikimi i proceseve të dizanjimit, eksplrimi i ndërfaqes në Scratch , krijimi i projekteve biografike në Scratch.
- Ndarja e këngëve dhe historive të preferuara të nxënësve nëpërmjet projekteve të Scratch.
- Krijimi i një përmbledhjeje të aktiviteteve apo detyrave të nevojshme për të përfunduar një projekt.
- Gjatë të gjitha seancave mësimore nxënësit punojnë në projektin final të tyre në Scratch.

## 10.2 Tematika: Përpunimi digjital i të dhënave

**Përshkrimi i Tematikës:** Nxënësi është në gjendje të analizojë dhe interpretojë të dhëna statistikore nëpërmjet programeve të paketës Windows Office. Në këtë cikël synohet që nxënësi të zhvillojë aftësi, qëndrime dhe njohuri që do t'i nevojiten atij në jetën e përditshme, por edhe për ta aftësuar më shumë në përdorimin e thelluar të kompjuterit dhe internetit. Nxënësit përdorin në mënyrë të avancuar shumë medie për realizimin e detyrave, punëve praktike dhe projekteve.

### Rezultatet e të nxënësve për kompetencat e fushës:

*Kreativiteti dhe inovacioni:* planifikon dhe menaxhon projekte digjitale për të krijuar informacion interaktiv. Korrigjon tekstet nga ana ortografike duke përdorur fjalorin elektronik si dhe e formatojnë sipas modelit të kërkuar.

*Kërkimi dhe gjetja e informacionit:* analizonë dhe vlerësojnë të dhëna nga një sërë burime për të modeluar dhe krijuar zgjidhje

*Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:* përfshijnë marrjen e vendimeve përsëritjen dhe ndërfaqen e projektuar të përdorur dhe implementojnë zgjidhjet e tyre digjitale duke përfshirë programet vizuale.

*Operacionet baze dhe konceptet teknologjike:* kupton dhe përdor saktë sistemet e teknologjisë; përzgjedh dhe përdor aplikacionet në mënyrë efektive dhe produktive; zgjidh problemet e sistemeve dhe e aplikacioneve; njohuritë e fituara i vë në funksion të mësimin të teknologjive të

reja.	
Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
<p><b>NJOHURITË KLASA 8</b></p> <p><b>Përpunimi digjital i tekstit</b></p> <p><b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njohin programet për përpunimin e tekstit online dhe ato pa pagesë;</li> <li>• njohin ndryshimet midis programeve edituese dhe atyre për afishimin e dokumenteve;</li> <li>• mësojnë si të përpunojnë tekstin duke bërë vendosjen, pozicionimin dhe shkallëzimin e objekteve multimediale si grafikët dhe fotografitë;</li> <li>• mësojnë si të krijojnë shabllone të gatshme për të dërguar letra, ftesa apo kartolina për evente të ndryshme;</li> <li>• mësojnë të përpunojnë grafikët dhe fotografitë në disa mënyra duke ndryshuar opsionet dhe cilësitë;</li> <li>• përdorin ikonën e SMART ART për të bërë kartat konceptuale, që kërkohen nga mësuesit e lëndëve;</li> <li>• kuptojnë një artikull analitik dhe dinë të nxjerrin në pah idetë kryesore duke përdorur SMART ART;</li> <li>• përpunojnë edhe organizojnë dokumentet në format pdf dhe kuptojnë ndryshimin e punës me formate të tilla.</li> </ul>	<p><b>Përpunimi digjital i tekstit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Heton se si të dhënat transmetohen dhe sigurohen në rrjetet Wireless, mobile dhe si specifikimet e komponentëve hardware ndikojnë në rrjetin e aktiviteteve.</li> <li>- Merr të dhëna nga një sërë burimesh dhe vlerëson origjinalitetin saktësinë dhe afatet kohore.</li> <li>- Analizon dhe paraqet të dhëna duke përdorur një sërë programesh për të krijuar informacion dhe përdor të dhënat e strukturuar për të modeluar objekte ose ngjarje.</li> <li>- Harton eksperiencën e përdoruesit të një sistemi digjital, gjenerimin, vlerësimin dhe planet alternative të komunikimit.</li> <li>- Vlerëson se sa mirë është zhvilluar zgjidhjet dhe janë përmbushur nevojat ekzistuese të sistemeve të informacionit, të rejat dhe marrja parasysh e rreziqeve dhe qëndrueshmërisë në të ardhmen.</li> <li>- Heton se si sistemet digjitale paraqesin tekst, imazh dhe audio të dhëna binare.</li> <li>- Zbaton zgjidhje digjitale si programe të thjeshta vizuale që përfshijnë degëzime,</li> </ul>

përsëritje dhe të dhëna përdoruesi.

- Merr, ruan dhe vlerëson lloje të ndryshme të të dhënave dhe përdor një sërë software-sh të zakonshme për të interpretuar dhe kujtuar të dhënat në kontekst për të krijuar informacion.
- Planifikon dhe menaxhon projekte duke përfshirë detyra, kohë dhe burime të tjera të nevojshme duke marrë parasysh sigurinë dhe qëndrueshmërinë.
- Në mënyrë të pavarur zbaton strategjitë për përcaktimin e llojit të duhur të informacionit digjital të përshtatshëm për ruajtjen e vendndodhjes dhe sigurinë për mjediset online.
- Përdor një gamë të TIK-ut për identifikimin dhe paraqitjen në grupe të informacionit dhe paraqet pyetje për të ndjekur kërkimin ose gjenerimin për informacionin e mëtejshëm.
- Vlerëson përshtatshmërinë e të dhënave ose informacionin duke pasur parasysh kriteret e përshtatshme.
- Përdor TIK-un e duhur për të gjeneruar ide bashkërisht dhe zhvillon plane.
- Drejton dhe mban të dhëna në servera të ndryshëm .

**Qëndrime dhe vlera:**

- Ka qëndrim aktiv drejt kërkimit të informacionit
- Vlerëson aspektet pozitive të teknologjive për korrigjimin e informacionit.
- Është i motivuar të kërkojë informacion për aspekte të ndryshme të jetës së tij/asaj.
- Është kurioz rreth sistemeve të informimit dhe funksioneve të tyre.
- Arsyeton që jo i gjithë informacioni mund të merret në internet.
- Është kritik ndaj informacionit të gjetur.
- Është i vetëdijshëm pavarësisht globalizimit të vendeve të caktuara janë më të pranishëm në internet.

### **Veprimtaritë e sugjeruara**

- Një dokument të dhënë nga mësuesi/ja nxënësit do ta përmirësojnë, duke përdorur veglat dhe komandat të tilla, si: ngjitje speciale (*Paste Special*), ndërprit faqen (*Page Break*), tabela, plumbime e numërim (*bullets and numbering*), bordura dhe ngjyrosje me të errët aty ku është e nevojshme (*borders and shading*) dhe *smart art*, për t'i shtuar dokumentit fleksibilitetin dhe sofistikimin e kërkuar.

Në orën praktike nxënësit përdorin Photoshop-in për ndryshimin e fotografive (si ato festive etj.) për të prodhuar një kolazh të thjeshtë fotografish.

- Nxënësit përdorin edhe veglat në Microsoft Word për të prerë, ndryshuar ngjyrat dhe tonalitetet, rrotulluar dhe pjerrësuar objektet. Ata aftësohen në përdorimin e shiritit të veglave të vizatimit të Wordit (*Word drawing toolbar*).
- Në orë praktike presin disa këngë të preferuara për një *kuic* në klasë.
- Për orët autoriale mund të incizojnë vetë nxënësit punën në kompjuter.



### 10.3 Tematika: Kërkimi në web/Internet, e-maili dhe chat-i

**Përshkrimi i Tematikës:** Nxënësi shkruan dhe hap link-e nëpërmjet faqeve kërkuese. Di të navigojë nëpër faqet e internetit, përdor lehtësisht internetin ose burime të tjera elektronike për kërkim informacioni. Gjithashtu ruan dhe shkarkon informacione në një server online.

Nxënësit njohin specifikimet e motorëve të kërkimit dhe janë në gjendje të kërkojnë informacione në portale të ndryshme elektronike. Ata njohin dhe përdorin në mënyrë të saktë mjetet mediatike, si dhe funksionin dhe rolin e secilit mjet. Nxënësi njihet me rreziqet që vijnë nga përdorimi i faqeve të web-it, të cilat nuk ofrojnë siguri të lartë për te dhe nuk publikojnë të dhëna personale që çenojnë sigurinë e tyre personale, duke e demonstruar përmes veprimeve nevojën për realizimin e tij në shtëpi, komunitet dhe shkollë, sipas rregullave të sigurta.

#### Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

*Komunikimi dhe bashkëpunimi:* përdor protokolle të miratuara kur komunikon dhe bashkëpunon online.

*Kërkimi dhe gjetja e informacionit:* përcakton/vendos strategjinë e kërkimit të informacionit; gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe mediave; për zgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave (apo problemeve të veçanta); përpunon të dhënat dhe raporton rezultatet; përdor informacionin e fituar për punë të pavarur duke iu referuar edhe te drejtave të autorit.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
<p><b>NJOHURITË KLASA 8</b></p> <p><b>Kërkimi në web/internet</b></p> <p><b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• njohin standartet dhe protokollet për ndertimin e internetit;</li><li>• njohin protokollin TCP/IP për komunikim në internet;</li><li>• njohin protokollin FTP dhe përdorimin e tij në rrjet;</li><li>• njohin disa shërbime të rëndësishme të web-it;</li><li>• kujdesen për postimet e informacioneve në web;</li><li>• kërkojnë dhe abonojnë Podcasts;</li><li>• njohin përdorimin e RSS/lajmeve të shkurtra;</li></ul>	<p><b>Kërkimi në web/internet</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Krijon dhe komunikon ide dhe informacione interaktive bashkarisht online duke marrë parasysh kontekstin social.</li><li>- Zbaton praktika që përputhen me detyrimet ligjore që kanë të bëjnë me pronësinë dhe përdorimin e produkteve dhe burimeve digjitale.</li><li>- Lokalizon, rigjen ose gjeneron</li></ul>

- përdorin periodikët elektronikë për kërkim dokumentacionesh zyrtare;
- ruajnë, përpunojnë apo ngarkojnë dokumentet në hapësira virtuale si *Google Doc ose ne opsione te ngjashme* nga USB, PC etj.;
- përdorin *Google Group ose opsione te ngjashme*, për t'i shpërndarë dokumentet dhe për t'i përpunuar njëkohësisht me miqtë e grupit.
- Telnet dhe forumet
- Telefonia në Internet, avantazhet dhe teknologjia

#### **Kërkimi në e-maili dhe chat-i**

- ruajnë rregullat e komunikimit në e-mail/ chat;
- skanojë me antivirus bashkëngjitjet e shkarkuara nga e-mail-et;
- ruhen në chat nga njerëzit e panjohur ose nga dhuna psikologjike, që u shkaktohet nëse ata janë nën ndikimin e materialeve me përmbajtje seksuale, të cilat transmetohen nëpërmjet kamerës dhe e-mail-it;
- sinjalizojnë abuzimet nëse ndodh diçka e tillë.

informacionin duke përdorur motorët e kërkimit ose funksionet e thjeshtë të kërkimit dhe klasifikon informacionin në mënyra kuptimplote.

- Në mënyrë të pavarur ose bashkërisht krijojnë dhe modifikojnë zgjidhjet digjitale rezultatet ose të dhënat krijuese përfaqësimi/transformimi për audiencë dhe qëllime të veçanta.
- Zgjedh dhe përdor mjetin TIK të përshtatshëm për të ndarë dhe shkëmbyer informacione dhe të bashkëpunojë me të tjerët në mënyrë të sigurt .

#### **Qëndrime dhe vlera:**

- Është i sigurt dhe i qetë gjatë komunikimit dhe shprehjes nëpërmjet mediave digjitale.
- Është i vetëdijshëm për kodin e mirësjelljes në përshtatje me kontekstin.
- Është i vetëdijshëm për rrezikun lidhur me komunikimin online me persona të panjohur.
- Angazhohet në mënyrë aktive në komunikimin online.

- Është i gatshëm të zgjedhë mjetet më të përshtatshme të komunikimit sipas qëllimit.
- Merr qëndrim aktiv në shpërndarjen e burimeve, përmbajtjes dhe njohurive.
- Ka opinionin e vet të informimit rreth shpërndarjes së praktikave, përfitimeve, rreziqeve dhe kufizimeve.
- Pranon dhe vlerëson diversitetin.
- Ka qëndrim të sigurt dhe të ndjeshëm në aktivitetet digjitale.
- Ka një opinion të informimit të autorizimit të praktikave.
- Është i vetëdijshëm për çështjet e të drejtës së autorit.
- Është i vetëdijshëm për potencialin e teknologjive dhe mediave për pjesëmarrje.
- Kë një arsytim kritik të medias sociale, rrjeteve dhe komunikimeve online
- Angazhohet me pjesëmarrje në media.

### **Veprimtaritë e sugjeruara**

- Nxënësit mirë informohen mbi e-mail-in, duke e parë atë si aplikim bazë të internetit.

Në një orë praktike nxënësit realizojnë një fletëpalosje ose një artikull në faqen web të shkollës me informacion mbi strukturën themelore të e-mail-it, duke shpjeguar me anë të një diagrami mënyrën se si një e-mail udhëton nga kompjuteri i tij/saj te marrësi.

*(Këtu informacioni mund të lidhet me studimin e kujtesës së kompjuterit, magazinimin dhe sigurinë nga viruset.)*

- Reflektim dhe diskutim në klasë për mundësitë, të mirat dhe të këqijat e chat-it dhe krijimi i një tabele me rregullat e komunikimit.

Krahasim me studimet e fundit. Orë praktike me anë të chat-eve për nxënës.

- Nxënësit përdorin faqet me fjalorë për të përkthyer tekstet e thjeshta, pasi gjejnë informacion në faqet ose blogjet e përshtatshëm për moshën

dhe lëndën.

-Materialet publikohet në webfaqen ose shpërndahet me e-mail.

-Për të ruajtur faqet burimore ata mësojnë ruajtjen e lidhjeve (duke përdorur shiritin e lundrimit), konceptin e *metadave* dhe rregullat elundrimit.

-Orë me role (udhëtari):

Përdorimi i Google Maps ose Google Earth për gjetjen dhe përlllogaritjen e rrugëtimit në destinacione të dëshiruara. Plotësimi i formularëve on line.

- Hapja, sigurimi dhe kyçja me w-lan (rrjet pa tela).

- Nxënësi/ja do të krijojë faqe web të thjeshta me arkitrarë, kolona, foto dhe kontroll tipografik (*headers, columns, photographs, and typographic control*).

- Nxënësit eksplorojnë përdorimin dhe rreziqet e punës në rrjet shoqëror.

- Duke përdorur Facebook-un si fillim, ata do të eksplorojnë site të tjera rrjetesh shoqërore të tilla, si: *Twitter, Flickr* dhe *Tumblr*.

#### **10.4 Tematika: Hyrje në Programim dhe Excel-i**

**Përshkrimi i Tematikës:** Nxënësi është në gjendje të analizojë dhe interpretojë të dhëna statistikore nëpërmjet programeve të paketës Windows Office. Në këtë cikël synohet që nxënësi të zhvillojë aftësi, qëndrime dhe njohuri që do t'i nevojiten atij në jetën e përditshme, por edhe për ta aftësuar më shumë në përdorimin e thelluar të kompjuterit. Me anë të programit të Excelit, nxënësit përpunojnë të dhënat duke përdorur tabela, lista, piktura grafike, kolona grafike dhe vija grafike.

#### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:**

*Kreativiteti dhe inovacioni duke përdorur teknologjinë:* përdor kompjuterin për të zhvilluar të menduarit kreativ dhe konstruktiv apo për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin.

*Kërkimi dhe gjetja e informacionit:* përcakton strategjinë e kërkimit të informacionit; duke përdorur kompjuterin gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe mediave; përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave.

*Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:* vlerëson sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre në termat e mbledhjes së kërkesave, të rejave dhe qëndrueshmërisë.

*Operacionet baze dhe konceptet teknologjike:* Shpjegon se si sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre përmbushin nevojat duke marrë parasysh qëndrueshmërinë.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
<p><b>NJOHURITË KLASA 8</b></p> <p><b>Hyrje në programim dhe Excel-i</b></p> <p><b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njihen me formulat dhe funksionet bazë të programit të Excel-it;</li> <li>• analizojnë disa të dhëna kur u jepet një tabelë në Excel;</li> <li>• njohin dhe zbatojnë konceptin e referencës relative, absolute dhe mikse;</li> <li>• filtrimi i të dhënave në Excel duke përdorur opsionet e avancuara;</li> <li>• importimi i të dhënave në Excel;</li> <li>• njohja me sistemin e programimit Visual BASIC (VB);</li> <li>• ndertimi i projekteve, shkrimi dhe ekzekutimi i programit në VB;</li> <li>• ndertimi i formulareve;</li> <li>• deklarimi i variablave dhe përdorimi i tyre;</li> <li>• përdorimi i operatoreve aritmetik, krahasues dhe logjik;</li> <li>• afishimi/leximi shkrimi i programeve të thjeshta në VB;</li> <li>• rregullat për shkrimin e funksioneve;</li> <li>• disa funksione të rëndësishme në VB;</li> <li>• integrimi i VB në Excel (Visual Basic for Applications);</li> <li>• motivimi për përdorimin e VBA në Excel;</li> </ul>	<p><b>Hyrje në programim dhe Excel-i</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Merr të dhëna nga disa burime dhe vlerëson origjinalitetin, saktësinë dhe afatet kohore.</li> <li>- Analizon dhe parashikon të dhënat duke përdorur disa programe për të krijuar informacionin dhe përdor të dhëna të strukturuar për të krijuar projekte të veçanta.</li> <li>- Kupton çdo të thotë grumbullim dhe përpunim të dhënash shifrore.</li> <li>- Kupton që për të grumbulluar, organizuar dhe përpunuar të dhëna shifrore përdoren programe të hartuar posaçërisht për këtë qëllim.</li> </ul>

- Shembuj të thjeshtë të përdorimit të VBA në Excel;

- Njeh funksionet më të përdorshëm të programit Microsoft Excel.
- Ndërton tabela për grumbullim të dhënash me qëllim përpunimi.
- Kryen punime të thjeshta të dhënash.
- Përdor disa nga formulat më të domosdoshme për përpunime të thjeshta
- Organizon në faqet e punës, tabela me objekt të caktuar dhe ti printojë ato.

**Qëndrime dhe vlera:**

- Ka qëndrim aktiv drejt mbledhjes dhe organizimit të informacionit
- Vlerëson aspektet pozitive të teknologjive për korrigjimin e informacionit.
- Është i motivuar të kërkojë informacion dhe ta paraqesë për aspekte të ndryshme të jetës së tij/asaj.
- Është kurioz rreth sistemeve të informimit dhe funksioneve të tyre.
- Arsyeton që jo i gjithë informacioni mund të merret në internet.
- Është kritik ndaj informacionit të gjetur.

**Veprimtaritë e sugjeruara:**

-Ndërtimi dhe korrigjimi i tabelave me të dhënat e ndryshme, me temë shoqërore (numri i popullsisë në Evropë, shpenzime të muajit etj.).

Shtimi i një kolone për përqindjet dhe realizimi i një grafike të përshtatshme.

-Duke punuar me një temë të përcaktuar nga mësuesi/ja, nxënësi/ja do të kërkojë dhe gjejë të dhëna, Këto të dhëna do të përdoren për të krijuar një fletë (spreadsheet) bazë të formatuar në Excel (me kolona dhe rreshta).

-Ata përdorin lloje të ndryshme tabelash, grafikësh dhe formulash, duke eksploruar fuqinë e Excel-it për të ekspozuar të dhënat në mënyrën më informuese.

-Duke punuar me një temë të përcaktuar nga mësuesi, studenti do të kërkojë dhe gjejë të dhëna, Këto të dhëna pastaj do të përdoren për të krijuar një çarçaf (spreadsheet) bazë të formatuar në Excel.

### 10.5 Tematika: Prezantimi digjital

**Përshkrimi i Tematikës:** Nxënësi krijon prezantime të mundësuar me grafikë, përdorin PowerPoint për të shkuar përtej vetëm-tekstit. Eksplorojnë mundësitë, por gjithashtu kuptojnë se shumë kambana dhe simbole (gjëra të kota) do ta largojnë nga qëllimet e prezantimit. Njihet me rreziqet që vijnë nga përdorimi i faqeve të web-it, të cilat nuk ofrojnë siguri të lartë për te dhe nuk publikojnë të dhëna personale që cenojnë sigurinë e tyre personale, duke e demonstruar përmesveprimevevojë për realizimin e tij nështëpi, komunitetdheshkollë, sipas rregullave të sigurta

#### Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

*Komunikimi dhe bashkëpunimi:* ndërvepron, bashkëpunon dhe publikon me moshatarët në mënyrë të sigurt online, zhvillon vetëdijen/ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e sigurisë online duke bashkëpunuar me moshatarët e tjerë; kontribuon në rritjen e rendimentit të punës në grupet e projekteve për të sjellë produkte origjinale apo për të zgjidhur problemet; të ruaj etikën e komunikimit personale dhe atë të grupit; të përdorë mjete të shumëllojshme .

*Kërkimi dhe gjetja e informacionit:* përcakton/vendos strategjinë e kërkimit të informacionit; gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe mediave; përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave (apo problemeve të veçanta); përpunon të dhënat dhe raporton rezultatet; përdor informacionin e fituar për punë të pavarur duke iu referuar edhe te drejtave të autorit.

*Operacionet baze dhe konceptet teknologjike:* kupton dhe përdor saktë sistemet e teknologjisë; mbron pajisjet e veta dhe kupton rrezikun online dhe kërcënimet; zgjidh problemet e sistemeve dhe e aplikacioneve; njohuritë e fituara i vë në funksion të mësimit të teknologjive të reja.

<b>Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës</b>	<b>Aftësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës</b>
NJOHURITË KLASA 8 Prezantimi digjital	Prezantimi digjital PowerPoint

Nxënësit:

- ngjisin dhe përpunojnë grafikët ose fotografitë në faqet e prezantimit;
- kombinojnë fotografitë dhe tabelat në mënyrë kreative duke përdorur Custom Animations;
- krijojnë albume fotografike duke përdorur opsionet e avancuara të Power-Point;
- përdorin shabllonet dhe konceptet e pamjeve gjatë përpunimit të prezantimit;
- përdorin efektet vizuale dhe auditive;
- përdorin mundësitë grafike të PowerPoint-it për të zmadhuar prezantimin e tekstit;
- njohin raportin midis efekteve dhe informacionin që do të përçohet tek audiencia bazuar te tematika e prezantuar;
- njohin llojet e prezantimit online dhe offline, dhe avantazhet dhe disavantazhet e gjithsecilit prej tyre;
- njohin programe të tjera për krijimin e prezantimeve.

- Përdor sistemet digjitale për të vërtetuar të dhënat p.sh. vendosja e llojeve të të dhënave në një spreadsheet për tu siguruar që një e dhënë është futur saktë.
- Paraqet dhe komunikon idetë e hartuara duke përdorur standardet e modelimit dhe dizenjimit duke përfshirë teknologjitë digjitale p.sh. simbolet dhe kodet në diagram, hartat e ilustruara, pamjet ajrore duke përdorur aplikacionet e shërbimit web të hartave.

#### **Qëndrime dhe vlera:**

- Konsideron parimet etike të përdorimit dhe publikimit të informacionit.
- Ka ndjenjë të përparuar të sjelljes së përshtatshme në lidhje me kontekstin e mediave, audiencën dhe dispozitat ligjore.
- Shfaq fleksibilitet dhe përshtatje me kulturat e ndryshme të komunikimit digjital.
- Të ketë qëndrim pozitiv por realist në lidhje me të mirat dhe rreziqet që shoqërohen teknologjitë e informacionit.
- Të kuptojnë që mjedisi digjital ku përballen mund të bëjë gjëra të mira dhe të këqija –varet nga ajo se si ne e përdorim atë dhe çfarë rregullash gjejmë për atë.
- Është i vetëdijshëm lidhur me çështjet mjedisore gjatë përdorimit të teknologjive digjitale.

#### **Veprimtaritë e sugjeruara**

- Nxënësit krijojnë një prezantim PowerPoint, ku kombinojnë tekstin me grafikën. Ata ua prezantojnë këtë prezantim shokëve të klasës.
- Nxënësit duke eksploruar dhe duke përdorur mundësitë grafike të PowerPoint-it për të zmadhuar prezantimin e tekstit, për të shkuar përtej me grafikë, ngjyra e sinjale, kuptojnë se cilat efekte do ta largojnë nga qëllimet e prezantimit.
- Në klasë krahasohen 2-3 lloje të prezantimeve për të arritur në atë më idealin.



-Nxënësit realizojnë një prezantim në klasë mbi ditë ose tema të shënuara, si: Dita e Verës, Dita e Pavarësisë, festat e fundvitit, prezantim të një shteti, ekskursioni, të një personazhi etj.

-Në bazë të tematikës përzgjidhen paraqitja, pamja, diagramet, tabelat, animacionet dhe vetitë e tyre, gjithnjë duke pasur parasysh rregullat e prezantimit.

### 7.3.1 Programi klasa e 9-të.

#### 11.1 Tematika: Bota e kompjuterit

**Përshkrimi i tematikës:**Nxënësi njihet me historinë e zhvillimit të kompjuterit dhe me klasifikimin e tij në gjenerata, me rëndësinë e mirëmbajtjes së tij dhe analizon marrëdhëniet dhe ndikimin e tij në shoqëri. Ai zhvillon aftësitë e përdorimit të mëtejshëm të kompjuterit për zhvillimin e kompetencës digjitale në të gjitha lëndët. Në këtë cikël synohet që nxënësi të zhvillojë aftësi, qëndrime dhe njohuri që do t'i nevojiten atij në jetën e përditshme, por edhe për ta aftësuar më shumë në përdorimin e thelluar të kompjuterit dhe internetit.

#### **Rezultatet e të nxënësve për kompetencat e fushës:**

*Kreativiteti dhe inovacioni duke përdorur teknologjinë:*Nxënësi përdor kompjuterin për të zhvilluar të menduarit kreativ dhe konstruktiv apo për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin.

*Komunikimi dhe bashkëpunimi:* Nxënësi ndërvepron, bashkëpunon dhe publikon me moshatarët, ekspertët apo të tjerët duke përdorur kompjuterin; përdor media dhe formate të ndryshme për komunikimin e informacionit dhe ideve në mënyrë efektive për audiencë të shumta.

*Kërkimi dhe gjetja e informacionit:*Nxënësi përcakton strategjinë e kërkimit të informacionit; duke përdorur kompjuterin gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe medieve;përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave.

*Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:*Nxënësi vlerëson sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre në termat e mbledhjes së kërkesave, të rejave dhe qëndrueshmërisë.

*Operacionet bazë dhe konceptet teknologjike:* Nxënësi shpjegon se si sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre përmbushin nevojat duke marrë parasysh qëndrueshmërinë.

**Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës**

**Aftësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës**

<p><b>NJOHURITË</b></p> <p><b>KLASA 9</b></p> <p><b>Bota e kompjuterit</b></p> <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njihen me historinë e zhvillimit të kompjuterit dhe klasifikimin e tij në gjenerata;</li> <li>• kuptojnë se si sisteme të ndryshme operative dhe aplikacione të ndryshme softuerike mund të instalohen dhe të përdoren nga i njëjti <i>hardware</i> (p.sh.: Windows ose Linux dhe MS Office ose LibreOffice në të njëjtin PC);</li> <li>• kuptojnë rëndësinë e mirëmbajtjes së kompjuterit dhe zgjidhin e parandalojnë problemet që lindin në kompjuter (<i>p.sh.: lidhja e pjesëve harduer, ruajtja dhe pastrimi nga viruset etj.</i>);</li> <li>• dallojnë ndryshimin mes kompjuterit dhe pajisjeve të ndryshme që përmbajnë pjesë kompjuterike;</li> </ul>	<p><b>Bota e kompjuterit</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon zhvillimin e teknologjisë në vite, si dhe rëndësinë e kompjuterit në jetën e përditshme;</li> <li>- harton përdorimin e eksperiencës së një sistemi digjital, për të prodhuar, vlerësuar dhe komunikuar projekte alternative;</li> <li>- është i aftë të zgjidhë një problem të thjeshtë teknik;</li> <li>- është në gjendje të kërkojë për burimet e informacionit kur i duhet ndihmë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme;</li> <li>- vlerëson se sa mirë janë zhvilluar zgjidhjet dhe janë përmbushur nevojat ekzistuese të sistemeve të informacionit, të rejtat dhe marrja parasysh e rreziqeve dhe qëndrueshmërisë në të ardhmen.</li> </ul>
<p><b>Qëndrime dhe vlera</b></p> <p>Nxënësi</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- është i përgjegjshëm gjatë përdorimit të mjeteve teknologjike;</li> <li>- kupton karakteristikat, tiparet dhe shfrytëzimin e mjediseve elektronike për bashkëpunim;</li> <li>- është i vetëdijshëm për rëndësinë e <i>back-up</i>;</li> <li>- është i vetëdijshëm për pasojat kur zbaton praktikatat për zgjidhjen e problemeve;</li> <li>- është i gatshëm të ndajë dhe të bashkëpunojë me të tjerët;</li> <li>- është i gatshëm të jetë pjesë e ekipit;</li> </ul>	

- merr pjesë aktive në zgjidhjen e problemit;
- është i gatshëm të kërkojë këshilla kur shfaqet një problem;
- mendon alternativat kur problemet nuk janë zgjidhur .

### Veprimtaritë e sugjeruara

- Diskutime në grup për rëndësinë e mirëmbajtjes së kompjuterit, si dhe krijimin e strategjive për gjetjen e zgjedhjes së problemeve të ndryshme gjatë punës në kompjuter.
- Instalimi i dy sistemeve operative në një kompjuter.
- Formatimi i kompjuterit, instalimi dhe radhitja, njohja dhe krahasimi i sistemeve operative *Linux me Windows* në një kompjuter ose laptop.
- Diskutim mbi rolin dhe zhvillimin e kompjuterit në jetën e përditshme. Analizë e varësisë nga kompjuteri.
- Avantazhet dhe disavantazhet në fushat e komunikimit, teknologjisë, sociologjisë, shëndetit etj.

## 9.2 Tematika: Përpunimi digjital i tekstit

**Përshkrimi i tematikës:** Nxënësi është në gjendje të analizojë dhe interpretojë të imazhe nëpërmjet programit *Photoshop*. Në këtë cikël synohet që nxënësi të zhvillojë aftësi, qëndrime dhe njohuri që do t'i nevojiten atij në jetën e përditshme, por edhe për ta aftësuar më shumë në përdorimin e thelluar të programeve kompjuterike. Nxënësit përdorin në mënyrë të avancuar shumë medie për realizimin e detyrave, punëve praktike dhe projekteve.

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

**Kreativiteti dhe inovacioni:** Nxënësi planifikon dhe menaxhon projekte digjitale për të krijuar informacion interaktiv. Modifikon imazhe duke përdorur mjetet e *Photoshop*-it për të arritur modelin e kërkuar.

**Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:** përfshijnë marrjen e vendimeve përsëritjen dhe ndërfaqen e projektuar të përdorur dhe implementojnë zgjidhjet e tyre digjitale duke përfshirë programet vizuale.

**Operacionet bazë dhe konceptet teknologjike:** Nxënësi kupton dhe përdor saktë sistemet e teknologjisë; përzgjedh dhe përdor aplikacionet në mënyrë efektive dhe produktive; zgjidh problemet e sistemeve dhe e aplikacioneve; i vë njohuritë e fituara në funksion të mësimin të teknologjive të reja.

**Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës**

**Aftësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës**

### NJOHURITË KLASA 9

#### Përpunimi digjital i tekstit

Nxënësit:

- njohin opsionet kryesore të përdorimit të *Photoshop*-it;
- shikojnë, presin dhe modifikojnë fotografitë me programet, si: *Photoshop (p.sh. i*

#### Përpunimi digjital i tekstit

Nxënësi

- është në gjendje të përdorë mjetet bazë për krijimin e përmbajtjes në forma të ndryshme;
- është i aftë të ndryshojë përmbajtjen e krijimit

<p><i>rrotullojnë, i zvogëlojnë/i zmadhojnë, ndryshojnë ngjyrat etj.);</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- qartësojnë fotografitë duke optimizuar kontrastin dhe ngjyrat;</li> <li>- komprimojnë dhe ruajnë fotografitë në formate të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- duke i dhënë formën e duhur;</li> <li>- analizon dhe paraqet të dhëna duke përdorur një sërë programesh për të krijuar informacion dhe përdor të dhënat e strukturuar për të modeluar objekte ose ngjarje;</li> <li>- është në gjendje të përdorë media të ndryshme për të shprehur kreativitetin e tij;</li> <li>- heton se si sistemet digjitale paraqesin tekst, imazh dhe audio të dhëna binare;</li> <li>- zbaton zgjidhje digjitale si programe të thjeshta vizuale që përfshijnë degëzime, përsëritje dhe përdorin të dhënat;</li> <li>- përdor TIK-un e duhur për të gjeneruar idebashkërisht dhe për të zhvilluar plane.</li> </ul>
<p><b>Qëndrime dhe vlera</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ka qëndrim kritik ndaj punës së krijuar dhe kërkon mënyra të reja për përmirësimin e saj;</li> <li>- vlerëson aspektet pozitive të teknologjive për modifikimin e krijimit;</li> <li>- kupton potencialin e teknologjisë dhe medias për shprehjen e ideve dhe të krijimeve;</li> <li>- angazhohet në krijimin e përmbajtjeve të ndryshme;</li> <li>- është kritik ndaj prodhimit dhe konsumimit të mediave dhe teknologjive;</li> <li>- vlerëson mediat e reja dhe proceset krijuese.</li> </ul>	
<p><b>Veprimtaritë e sugjeruara</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në orën praktike nxënësit përdorin <i>Photoshop</i>-in për ndryshimin e fotografive (<i>si ato festive etj.</i>) për të prodhuar një kolazh të thjeshtë fotografish.</li> <li>- Në orën praktike presin disa këngë të preferuara për një <i>kuic</i> në klasë.</li> <li>- Për orët autoriale nxënësit mund të incizojnë vetë punën në kompjuter.</li> </ul>	

### 9.3 Tematika: Kërkimi në web/Internet, e-maili dhe chat-i

**Përshkrimi i tematikës:** Nxënësi shkruan dhe hap *linqe* nëpërmjet faqeve kërkuese. Ai di të navigojë nëpër faqet e internetit, përdor lehtësisht internetin ose burime të tjera elektronike për kërkim informacioni. Gjithashtu, nxënësi ruan dhe shkarkon informacione në një server online. Nxënësi njeh specifikimet e motorëve të kërkimit dhe është në gjendje të kërkojë informacione në portale të ndryshme elektronike. Ai njeh dhe përdor në mënyrë të saktë mjetet mediatike, si dhe funksionin dhe rolin e secilit mjet. Nxënësi njihet me rreziqet që vijnë nga përdorimi i faqeve të web-it, të cilat nuk ofrojnë siguri të lartë për të dhe nuk publikon të dhëna personale që cenojnë sigurinë e tyre personale, duke e demonstruar përmesveprimevevojë për realizimin e tij nështëpi, komunitetdsheshkollë, sipas rregullave të sigurta.

#### Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

**Komunikimi dhe bashkëpunimi:** Nxënësi përdor protokolle të miratuara kur komunikon dhe bashkëpunon online.

**Kërkimi dhe gjetja e informacionit:** Nxënësi përcakton/vendos strategjinë e kërkimit të informacionit; gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe medieve; përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave (apo problemeve të veçanta); përpunon të dhënat dhe raporton rezultatet; përdor informacionin e fituar për punë të pavarur duke iu referuar edhe te drejtave të autorit.

**Vlerësimi i informacionit:** Nxënësi mbledh, përpunon, kupton dhe të vlerëson në mënyrë kritike informacionin.

#### Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës

#### Aftësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës

#### NJOHURITË KLASA 9

##### Kërkimi në web/internet

Nxënësit:

- njohin disa strategji dhe opsione të kërkimit të informacionit në internet;
- mësojnë të lokalizojnë vende të ndryshme nëpërmjet internetit (p.sh., hartat e qyteteve, aeroportet);
- mësojnë të përdorin teknologjinë në shërbim të nevojave të tyre personale (p.sh. të aplikojnë për tu regjistruar në kurse/shkolla të ndryshme);

##### Kërkimi në e-maili dhe chat-i

- krijojnë faqe të thjeshta interneti nëpërmjet programeve kompjuterike ose sistemeve, si p.sh.: CMS, Blog etj.;
- shkarkojnë dhe instalojnë përditësimet e programeve aplikative, si: antiviruset etj.;
- përdorin me kujdes komunikimin në rrjetet sociale, si Lojrat online, *Facebook* etj., duke

##### Kërkimi në web/internet

- Krijon dhe komunikon ide dhe informacione interaktive bashkarisht online duke marrë parasysh kontekstin social.
- Zbaton praktika që përputhen me detyrimet ligjore që kanë të bëjnë me pronësinë dhe përdorimin e produkteve dhe burimeve digjitale.
- Lokalizon, rigjen ose gjeneron informacionin duke përdorur motorët e kërkimit ose funksionet e thjeshtë të kërkimit dhe klasifikon informacionin në mënyra kuptimplote.
- Zgjedh dhe përdor mjetin TIK të

shmangur dëmtimin e privatësisë.

përshtatshëm për të ndarë dhe shkëmbyer informacione dhe të bashkëpunojë me të tjerët në mënyrë të sigurt.

- Paraqet dhe komunikon idetë e hartuara duke përdorur standardet e modelimit dhe dizenjimit duke përfshirë teknologjitë digjitale p.sh. simbolet dhe kodet në diagram, hartat e ilustruara, pamjet ajrore duke përdorur aplikacionet e shërbimit web të hartave.
- Vlerëson përshtatshmërinë e të dhënave ose informacionin duke pasur parasysh kriteret e kërkimit.

### **Qëndrime dhe vlera**

Nxënësi:

- Është i sigurt dhe i qetë gjatë komunikimit dhe shprehjes nëpërmjet medieve digjitale.
- Është i vetëdijshëm për kodin e mirësjelljes në përshtatje me kontekstin.
- Është i vetëdijshëm për rrezikun lidhur me komunikimin online me persona të panjohur.
- Angazhohet në mënyrë aktive në komunikimin online.
- Është i gatshëm të zgjedhë mjetet më të përshtatshme të komunikimit sipas qëllimit.
- Merr qëndrim aktiv në shpërndarjen e burimeve, përmbajtjes dhe njohurive.
- Ka opinionin e vet të informimit rreth shpërndarjes së praktikave, përfitimeve, rreziqeve dhe kufizimeve.
- Pranon dhe vlerëson diversitetin.
- Ka qëndrim të sigurt dhe të ndjeshëm në aktivitetet digjitale.
- Ka një opinion të informimit të autorizimit të praktikave.
- Është i vetëdijshëm për çështjet e të drejtës së autorit.
- Është i vetëdijshëm për potencialin e teknologjive dhe mediave për pjesëmarrje.
- Kë një arsytim kritik të medias sociale, rrjeteve dhe komunikimeve online
- Angazhohet me pjesëmarrje në media.

### **Veprimtaritë e sugjeruara**

- Nxënësit mirinformohen mbi e-mail-in, duke e parë atë si aplikim bazë të internetit.

Në një orë praktike nxënësit realizojnë një fletëpalosje ose një artikull në faqen web të shkollës me informacion mbi strukturën themelore të e-mail-it, duke shpjeguar me anë të një diagrami mënyrën se si një e-mail udhëton nga kompjuteri i tij/saj te marrësi.

*(Këtu informacioni mund të lidhet me studimin e kujtesës së kompjuterit, magazinimin dhe sigurinë nga viruset.)*

-Reflektim dhe diskutim në klasë për mundësitë, të mirat dhe të këqijat e chat-it dhe krijimi i një tabele me rregullat e komunikimit.

Krahasim me studimet e fundit. Orë praktike me anë të chat-eve për nxënës.

-Nxënësit përdorin faqet me fjalorë për të përkthyer tekstet e thjeshta, pasi gjejnë informacion në faqet ose blogjet e përshtatshëm për moshën dhe lëndën.

-Materialet publikohet në webfaqen ose shpërndahe me e-mail.

-Për të ruajtur faqet burimore ata mësojnë ruajtjen e lidhjeve (duke përdorur shiritin e lundrimit), konceptin e *metadave* dhe rregullat elundrimit.

-Orë me role (udhëtari):

Përdorimi i Google Maps ose Google Earth për gjetjen dhe përlllogaritjen e rrugëtimit në destinacione të dëshiruara. Plotësimi i formularëve on line.

- Hapja, sigurimi dhe kyçja me w-lan (rrjet pa tela).

- Nxënësi/ja do të krijojë faqe web të thjeshta me arkitrarë, kolona, foto dhe kontroll tipografik (*headers, columns, photographs, and typographic control*).

- Nxënësit eksplorojnë përdorimin dhe rreziqet e punës në rrjet shoqëror.

- Duke përdorur Facebook-un si fillim, ata do të eksplorojë site të tjera rrjetesh shoqërore të tilla, si: *Twitter, Flickr* dhe *Tumblr*.

## **9.4 Tematika: Hyrje në programim**

**Përshkrimi i tematikës:** Nxënësi arrin të kuptojë konceptin dhe parimet e programimit kompjuterik, të përcaktojë parametrat, të modifikojë programet, aplikacionet programore, softuerët, pajisjet, për të kuptuar se çfarë qëndron pas një programi. Në këtë cikël synohet që nxënësi të zhvillojë aftësi, qëndrime dhe njohuri që do t'i nevojiten atij në jetën e përditshme, por edhe për ta aftësuar më shumë në përdorimin e thelluar të kompjuterit. Me anë të programit Scratch, nxënësi arrin të krijojë projekte të thjeshta duke zhvilluar intuitën dhe aftësinë në përdorimin e gjithëve të programimit.

### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:**

*Kreativiteti dhe inovacioni duke përdorur teknologjinë:* Nxënësi përdor kompjuterin për të zhvilluar të menduarit kreativ dhe konstruktiv apo

për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin.

*Kërkimi dhe gjetja e informacionit:* përcakton strategjinë e kërkimit të informacionit; duke përdorur kompjuterin gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe mediave; përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave.

*Mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:* vlerëson sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre në termat e mbledhjes së kërkesave, të rejave dhe qëndrueshmërisë.

*Operacionet bazë dhe konceptet teknologjike:* Shpjegon se si sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre përmbushin nevojat duke marrë parasysh qëndrueshmërinë.

Nëpërmjet gjuhës së thjeshtë të programimit pritet që nxënësit të njihen me koncepte të programimit dhe të mjedisit Scratch dhe t'i zbatojnë ato gjatë realizimit të detyrave ose projekteve kurrikulare.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës	Aftësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës
<b>NJOHURITË KLASA 9</b>	<b>Siguria në internet</b>
<p><b>Gjuha e programimit (aplikimi i formulave bazë)</b>  <b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shqyrtojnë zhanret dhe format e ndryshme të shprehjes kreative, duke krijuar familjaritet dhe rrjedhshmëri me konceptet dhe praktikat kompjuterike.</li> <li>• kuptojnë konceptin e programimit kompjuterik në kontekstin e Scratch.</li> <li>• familjarizohen me një gamë të gjërë të bloqeve të <i>Scratch</i>.</li> <li>• krijojnë një projekt të thjeshtë në <i>Scratch</i>.</li> <li>• Mësojnë të zgjerojnë projektin në Scratch duke shtuar animime dhe muzikë;</li> <li>• futen në konceptet e programimit (si sekuenat, loops, ngjarjet) dhe praktikojnë testimin dhe debugging duke punuar në projekte të tyre</li> <li>• krijojnë një projekt në <i>Scratch</i> që tregon një histori, një ngjarje.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizon dhe strukturon të dhënat duke përdorur disa programe për të krijuar projekte të veçanta.</li> <li>- Krijon modele komplekse, simulime dhe vizualizime të botës reale duke përdorur informacionin digjital.</li> <li>- Është në gjendje të kodojë dhe programojë pajisjet digjitale</li> <li>- Mund të ndryshojë disa funksione të thjeshta të programit dhe aplikacioneve</li> </ul>
<p><b>Qëndrime dhe vlera</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Është i vetëdijshëm për proceset e ndodhura pas të menduarit kompjuterik</li> </ul>	



- Është kurioz për potencialin e TIK-ut për programimin dhe krijimin e rezultateve
- Është i motivuar të programojë dhe ta paraqesë për aspekte të ndryshme të jetës së tij/asaj.
- Është kurioz rreth sistemeve të informimit dhe funksioneve të tyre.
- Është kritik ndaj punës së vet dhe kërkon ta përmirësojë.

#### **Veprimtaritë e sugjeruara:**

- Prezantimi i koncepteve të programimit dhe të mjedisit të Scratch , prezantimi i shembujve të ndryshme të projekteve në Scratch.
- Rishikimi i proceseve të dizanjimit, eksplormi i ndërfaqes në Scratch, krijimi i projekteve biografike në Scratch.
- Ndarja e këngëve dhe historive të preferuara të nxënësve nëpërmjet projekteve të Scratch.
- Krijimi i një përmbledhje të aktiviteteve apo detyrave të nevojshme për të përfunduar një projekt.
- Gjatë të gjitha seancave mësimore nxënësit punojnë në projektin final të tyre në Scratch.

### **9.5 Tematika: Prezantimi digjital**

**Përshkrimi i Tematikës:** Nxënësi krijon prezantime të mundësuar me grafikë, përdor programin PowerPoint për të shkruar përtej vetëm-tekstit. Eksploron mundësitë, krijon dhe shton objekte 3D, por gjithashtu kupton masën e duhur të përdorimit të tyre në prezantim për të mos u larguar nga qëllimet e prezantimit. Më tej nxënësi zhvillon aftësitë e tij duke krijuar prezantime online në grup dhe arrin ta publikojë atë për një audiencë të caktuar.

#### **Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:**

*Komunikimi dhe bashkëpunimi:* ndërvepron, bashkëpunon dhe publikon me moshatarët në mënyrë të sigurt online, zhvillon vetëdijen/ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e sigurisë online duke bashkëpunuar me moshatarët e tjerë; kontribuon në rritjen e rendimentit të punës në grupet e projekteve për të sjellë produkte origjinale apo për të zgjidhur problemet; të ruaj etikën e komunikimit personale dhe atë të grupit; të përdorë mjete të shumëllojshme .

*Kërkimi dhe gjetja e informacionit:* përcakton/vendos strategjinë e kërkimit të informacionit; gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe medieve;përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrave (apo problemeve të veçanta); përpunon të dhënat dhe raporton rezultatet;

<p>përdor informacionin e fituar për punë të pavarur duke iu referuar edhe te drejtave të autorit.  <i>Operacionet baze dhe konceptet teknologjike:</i> kupton dhe përdor saktë sistemet e teknologjisë; mbron pajisjet e veta dhe kupton rrezikun online dhe kërcenimet; zgjidh problemet e sistemeve dhe e aplikacioneve; njohuritë e fituara i vë në funksion të mësimit të teknologjive të reja.</p>	
<p><b>Njohuritë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës</b></p>	<p><b>Aftësitë për realizimin e kompetencave të fushës/lëndës</b></p>
<p><b>NJOHURITË KLASA 9</b></p>	<p><b>Prezantimi digjital PowerPoint</b></p>
<p><b>Prezantimi digjital</b></p> <p><b>Nxënësit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kuptojnë që prezantimet digjitale mund të përdoren në mënyrë efektive për komunikimin e ideve;</li> <li>• planifikojnë dhe përgatisin një skicë për prezantimin;</li> <li>• krijojnë dhe modifikojnë objekte 3D dhe i sistemojnë në një pamje (<i>slide</i>);</li> <li>• përgatisin dhe transferojnë një video-klip në një prezantim;</li> <li>• Kërkojnë në internet template të gatshme prezantimi dhe e përshtatin prezantimin e tyre;</li> <li>• Mësojnë të krijojnë një prezantim online në grup.</li> <li>• Publikojnë prezantimin e tyre për një audiencë më të gjerë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në mënyrë të pavarur ose bashkërisht krijojnë dhe modifikojnë zgjidhjet digjitale rezultatet ose të dhënat krijuese përfaqësimi/transformimi për audiencë dhe qëllime të veçanta..</li> <li>- Është në gjendje të krijojë dhe të shtojë objekte 3D në prezantim.</li> </ul>
<p><b>Qëndrime dhe vlera:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Konsideron parimet etike të përdorimit dhe publikimit të informacionit.</li> <li>- Gjykon dhe vlerëson punën e të tjerëve.</li> <li>- Ka ndjenjë të përparuar të sjelljes së përshtatshme në lidhje me kontekstin e mediave, audiencën dhe dispozitat ligjore.</li> <li>- Shfaq fleksibilitet dhe përshtatje me kulturat e ndryshme të komunikimit digjital.</li> <li>- Të ketë qëndrim pozitiv por realist në lidhje me të mirat dhe rreziqet që shoqërohen teknologjitë e informacionit.</li> <li>- Të kuptojnë që mjedisi digjital ku përballen mund të bëjë gjëra të mira dhe të këqija, varet nga ajo se si ne e përdorim atë dhe çfarë rregullash gjejmë për atë.</li> <li>- Është i vetëdijshëm lidhur me çështjet mjedisore gjatë përdorimit të teknologjive digjitale.</li> </ul>	
<p><b>Veprimtaritë e sugjeruara</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit krijojnë një prezantim PowerPoint, ku kombinojnë tekstin me grafikën. Ata ua prezantojnë këtë prezantim shokëve të klasës.</li> </ul>	

- Nxënësit duke eksploruar dhe duke përdorur mundësitë grafike të PowerPoint-it për të zmadhuar prezantimin e tekstit, për të shkuar përtej me grafikë, objektet 3D, ngjyra e sinjale, kuptojnë se cilat efekte do ta largojnë nga qëllimet e prezantimit.
- Në klasë krahasohen 2-3 lloje të prezantimeve për të arritur në atë më idealin.
- Nxënësit realizojnë një prezantim në klasë mbi ditë ose tema të shënuara, si: Dita e Verës, Dita e Pavarësisë, festat e fundvitit, prezantim të një shteti, ekskursioni, përshkrimi i një personazhi etj.
- Në bazë të tematikës përzgjidhen paraqitja, pamja, diagramet, tabelat, animacionet dhe vetitë e tyre, gjithnjë duke pasur parasysh rregullat e prezantimit.

## **XI. Udhëzime metodologjike**

Teknologjia dhe TIK-u i ofrojnë shkollës potenciale të shumëfishta, si për shembull: me ndihmën e kompjuterit dhe të internetit zhvillohet të nxënit bashkëpunues, autonom dhe problemzgjdhës. Kjo kërkon përdorimin e duhur të mjeteve teknologjike, si dhe njohjen specifike të tyre. Në përgjithësi njeriu mëson nëpërmjet fitimit ose shkëmbimit të informacionit, vëzhgimit, iniciativës vetjake për gjetjen e zgjidhjes së problemit ose duke u motivuar nga strategjitë e të nxënit. Potencialet e mjeteve teknologjike sot përfshijnë edhe ofrimin e shërbimeve në këto drejtime, duke bërë të mundur të nxënë. P.sh.: *kompjuteri me programet dhe mundësitë e tij mund të kthehet në mjet burimor informacioni dhe komunikimi, gjithashtu ai është mbështetës, ilustrues, prezantues, ndihmës, plotësues i materialeve mësimore.* Në këtë formë, mësues-i/ja gjatë lëndës së TIK-ut nuk ndihmon vetëm nxënësit të përvetësojnë njohuritë e reja, por i ndihmon ata t'i përdorin këto njohuri edhe në lëndët e tjera. Mbarëvajtja e orës së mësimin arrihet me sukses gjatë gërshetimit të këtyre komponentëve: njohurive, aftësive dhe qëndrimeve. Njëra nga metodat më të sakta të përvetësimit të njohurive të TIK-ut do të ishte realizimi *iprojekteve kurrikulare*, në mënyrë që nxënësit të vënë në praktikë njohuritë e marra, si edhe t'i gërshetojnë këto njohuri me njohuritë e lëndëve të tjera. Në këtë mënyrë nxitet kreativiteti, zhvillohet motorika dhe nxitet të menduarit për zgjidhjen e problemeve. Suksesi i kësaj ore mësimore pasqyrohet sidomos në lirinë e fituar te nxënësit për t'i përdorur mjetet e TIK-ut. Nëpërmjet punës në grupe nxënësi vlerëson bashkëpunimin me shokët e shoqet e klasës, krijon lirshmërinë e vendimmarrjes dhe të përgjegjësisë ndaj komunitetit. Njohuritë e përfutuara gjatë orës mësimore bëhen më konkrete dhe më të realizueshme nëse detyrat lidhen edhe me veprimtaritë në shkollë dhe me veprimtaritë që nxënësit mund të realizojnë jashtë shkollës. *Puna në grup ose në dyshe*

jep mundësi për debat ose konsultim. Kështu zhvillohet përgjegjësia ndaj komunitetit ose komunikimi me të tjerë, duke fituar siguri vetjake, aftësi në përdorimin e saktë të mjeteve të TIK-ut me një synim të caktuar.

Për nxënësit do të ishin të përshtatshme edhe *metodat gjysmëkërkimore* për një problem të caktuar. Këto metoda i nxisin nxënësit të kërkojnë vetë në fillim zgjidhjen e problemit dhe, më pas, të punojnë në grup për zgjidhjen e plotë të tij. Gjatë këtyre hapave mësues-i/ja ka rolin e lehtësuesit dhe i ndihmon ata të shkojnë drejt zgjidhjes së duhur.

Për zhvillimin sa më të mirë të kompetencës digjitale tek nxënësit po dhe të kompetencave të tjera kyçe është të rëndësishme që gjithë ora e mësimit të jetë e bazuar në situata konkrete të cilat e kërkojnë zgjidhjen e problemit nëpërmjet të mësuarit duke bërë gjithashtu përpunimin e njohurive nëpërmjet punëve praktike.

### **Shembull konkret i përpunimit të njohurive (klasa 7-9)**

Interesi më i madh i TIK-ut në klasë është mbi të rejat që ai sjell ndërmjet informacionit dhe komunikimit.

- T'u dërgosh mesazhe shumë personave në të njëjtën kohë.
- Të vësh në dispozicion të nxënësve shumë informacione.
- Të përdorin forma të ndryshme burimesh, të gjetura në web ose në dokumente të shkruara.
- Të dialogosh shpejt dhe saktë në kohë reale.

Mësues-i/ja zbaton veprimtari metodike, duke përdorur burime të shumëllojshme. Një nga rastet konkrete do të ishte përdorimi i **klasës informuese**, e cila motivon nxënësit të punojnë së bashku, si edhe të marrë rolin si lider të informacionit.

#### **Klasa informuese**

Në klasat informuese, nxënësit mund të këmbëjnë informacion mes tyre. Në këtë formë të gjithë e njohin informacionin dhe, në të njëjtën kohë, nxënësit zhvillojnë aftësitë e bashkëpunimit me njëri-tjetrin. Është e rëndësishme që të jenë të ftuar edhe specialistë të fushës për të pasuruar mësimdhënien.

Rëndësia e këtyre veprimtarive është se shumë njerëz mund të diskutojnë në forma të ndryshme për të njëjtën temë, si edhe të kenë, gjithashtu, mendime të ndryshme mbi të njëjtën temë. Për këtë arsye, vendoset që një klasë të shërbejë si klasë informuese, në mënyrë që informacioni të përqendrohet në një vend dhe më pas të shpërndahet. Kjo detyrë mund të realizohet në tri faza, gjë që nënkupton në tri javë mësimore.

**Faza 1:** Klasa e caktuar si *klasë informuese* kërkon informacion mbi temën duke përdorur media të ndryshme (enciklopedi, video, CD-ROM, WEB), të cilat i lexojnë ose i shikojnë. Në të njëjtën kohë, mësues-i/ja realizon në klasë veprimtari që lidhen me mënyrën e të kuptuarit dhe të seleksionimit të informacionit. Këto shpjegime i ndihmojnë nxënësit që të përgatiten për të prodhuar këto lloje tekstesh shpjeguese. Në të njëjtën kohë, kjo lloj detyrë jep mundësinë të korrigjohen fenomenet ortografike dhe sintaksore. Më pas, ky informacion shpërndahet te klasat e tjera, të cilat mund të kërkojnë edhe më pak informacion mbi temën ose të përgatitin pyetje rreth temës së studiuar.

**Faza 2:** Nxënësit e klasës informuese realizojnë tekste mbi temën e zgjedhur. Në fund të këtyre detyrave nxënësit mund të organizojnë një ekspozitë brenda shkollës, në të cilën paraqesin krijimin e një faqeje web, ku vendosin punët e tyre dhe mund të përgatisin edhe dosje për nxënësit e tjerë. Qëllimi i këtij ushtrimi do të ishte vendosja në një dokument të vetëm e të gjitha informacioneve të gjetura gjatë fazës kërkimore.

**Faza 3:** Do të ishte arritja finale ku dhe nxënësit e klasave të tjera mund të kenë dëshirë të diskutojnë mbi temën dhe diskutimi realizohet online nëpërmjet e-mail-it.

Gjatë këtyre fazave janë përdorur të gjithë komponentët e TIK-ut:


- Kërkimi i informacionit në internet.
- Prodhimi i informacionit dhe publikimi i tij në faqe *web*.
- Kontaktimi i nxënësve të tjerë përmes e-mail-it.
- Qendërzimi i përgjigjeve në një dokument të vetëm.

Përdorimi i TIK-ut duhet të shihet si një mjet që i ndihmon nxënësit të përqendrohen më gjatë në klasë, pasi informacioni mund të transmetohet në forma të ndryshme: audio-vizive (eksperimentet virtuale, filmat dokumentarë, prezantime PowerPoint, postera, leximi i historive on line, të ritregojnë historinë duke e rishkruar në Word, të ndajnë informacione me shkollat e tjera nëpërmjet e-mail-it).

## XII. Udhëzime për vlerësimin


Gjatë procesit të vlerësimit në klasë mësuesit duhet të kenë në fokus vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe realizimit të kompetencave kyçe, por dhe kompetencave të fushës. Që vlerësimi të bazohet mbi arritjet e nxënësve duhet të mbahen në konsideratë disa parime kryesore.

### *Parimet kryesore të vlerësimit*



Vlerësimi formues duhet të jetë pjesë e situatave mësimore në të cilat ndodhen nxënësit. Gjithashtu është e rëndësishme që situatat mësimore të jenë komplekse në mënyrë që nxënësit të kenë më tepër lirshmëri për të dhënë zgjidhje problemore të ndryshme por edhe të zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues gjatë realizimit të situatës. Vlerësimi si proces lidhet me tërësinë e metodave, praktikave dhe teknikave që përdorin mësuesit për të testuar, për të kontrolluar, analizuar dhe për të matur nivelin e njohurive, aftësive dhe të performancës së nxënësve. Vlerësimi duhet të jetë i realizueshëm, i vlefshëm, korrekt, i besueshëm dhe i saktë. Vlerësimi duhet të japë një pasqyrë për arritjet e nxënësit, si edhe vështirësitë që mund të kenë nxënësit gjatë realizimit të detyrave ose projekteve kurrikulare. Të vlerësosh nxënësit nuk do të thotë vetëm t'i vendosësh atij një notë, por edhe ta ndihmosh atë të kalojë vështirësitë gjatë arritjes së kompetencave. Në skemën në vijim do të japin një shembull konkret se si mësuesi nis nga situata e të nxënësit për të realizuar vlerësimin e nxënësve.

*Hapat që mund të ndiqen për krijimin e një metodologjie vlerësimi që ndihmon në krijimin dhe vlerësimin e situatës.*






Vlerësimi në klasë luan një rol të rëndësishëm në mënyrën se si mësojnë nxënësit, në motivimin e tyre për të nxënë dhe në mënyrën e shpjegimit të mësuesit. Pyetjet që lidhen me cilësinë (besueshmërinë, burimet e referencës, vlefshmërinë) janë të rëndësishme për të gjitha llojet e vlerësimit në klasë.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është që nxënësit të bëhen autonomë dhe të jenë në gjendje të vetëvlerësojnë progresin e tyre. Vlerësimi bëhet në atë çka nxënësit kanë përvetësuar dhe janë të aftë të bëjnë. Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Mësuesit nuk e kanë të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe vendosjen e notave në regjistër për secilën orë mësimore.

Gjatë kohës që bëhet planifikimi i programit ose i vlerësimit, është e rëndësishme që të bëhen pyetjet e mëposhtme të cilat e ndihmojnë mësuesin të bëjë një vlerësim të bazuar në parime kryesore.



Në asnjë metodologji vlerësimi, qëllimi final nuk është që mësuesit ose vlerësuesit të arrijnë të përdorin të gjitha shkallët dhe tipat e vlerësimit (në të gjitha nivelet) në të njëjtën kohë. Dihet që mësuesit dhe vlerësuesit do të hasin vështirësi për të përdorur në të njëjtën kohë një numër të madh kategorish vlerësimi. Kështu del detyrë që në çdo praktikë vlerësimi, mësuesit dhe vlerësuesit duhet të përpiqen të zvogëlojnë numrin e kategorive të mundshme në një sasi lehtësisht të manipulueshme. Përvoja ka treguar se 4-5 kategori kërkojnë një përqendrim maksimal, ndërsa 7 kategori përbëjnë një prag psikologjik që nuk mund të kapërcehet. Pra, duhet bërë një zgjedhje. Një shembull konkret do të ishte: Nëse për realizimin e një detyre ka shumë kategori për t'u arritur, mësues-i/ja duhet të zgjedhë 4-5 kritere që mund të arrihen nga secili nxënës. Kategoritë gjatë realizimit të një projekti kurrikular dhe punës në grup:

- **Strategji e marrjes së fjalës**
- Strategji e bashkëpunimit
- Kërkesë për sqarime
- **Lirshmëria**
- Fleksibiliteti
- Koherenca
- **Zhvillimi tematik**
- Saktësia
- Fusha e përgjithshme
- Shtrirja e fjalorit
- **Burimet e përdorura për realizimin e punimit**
- Respektimi i kohës së prezantimit
- **Qartësia e *slide*-ve**

Kriteret kryesore që duhen të merren parasysh dhe që ta vlerësojnë nxënës-in/en në mënyrë sa më objektive do të ishin:

- **Zhvillimi tematik**
- **Strategji e marrjes së fjalës**
- **Burimet e përdorura për realizimin e punimit**
- **Lirshmëria**
- **Qartësia e *slide*-ve**

## **Disa lloje vlerësimi që mund të përdoren nga mësuesit:**

### **a. Vlerësimi formues**

Ky lloj vlerësimi duhet të realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga mësues-i/ja, në mënyrë që të kuptohen vështirësitë e nxënësve, më pas të shihet ecuria e tyre dhe në fund të kapitullit të shihet nëse janë arritur kompetencat e kërkuara. Për nxënësit e arsimit të mesëm të ulët, ky vlerësim është shumë i rëndësishëm pasi ata fillojnë të analizojnë në mënyrë të thelluar çfarë janë në gjendje të arrijnë dhe këtë ta përdorin si pikën e tyre të fortë. Gjatë këtij vlerësimi, mësues-i/ja duhet të vëzhgojë herëpashere nxënësit, të realizojë bashkëbisedime me ta, të realizojë produkte të ndërmjetme para produkteve finale. Ky lloj vlerësimi i ndihmon nxënësit të gjejnë mënyrën e duhur për të mësuarin efektiv.

### **b. Vlerësimi nëpërmjet portofolit**

Një formë tjetër vlerësimi, që e ndihmon nxënësin të shohë se si ai avancohet hap pas hapi, është edhe *vlerësimi nëpërmjet portofolit*. Portofoli i nxënësit është një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, i cili përmban një koleksion punimesh të organizuara prej tij gjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra shtëpie me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësues-i/ja është në rolin e atij që drejton dhe rekomandon. Qëllimi kryesor i portofolit është që nxënës-i/ja të koleksionojë ato dokumente që atij mund t'i shërbejnë në vitet në vijim. Gjithashtu, në portofol, nxënës-i/ja mund të shohë se si ai/ajo përparon nga muaji në muaj ose nga semestri në semestër.

### **c. Vetëvlerësimi**

Ky lloj vlerësimi është vetëgjykim i nxënësit për arritjet e tij. Vetëvlerësimi shpesh shërben si një plotësues i domosdoshëm i teknikave të vlerësimit, të bëra nga mësues-i/ja dhe nga provimet. Pika e fortë e vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është një faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi. Ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxënësit e tyre. Duhet theksuar që vetëvlerësimi është më i vlefshëm dhe më objektiv nëse nxënësit i jepen kritere të sakta mbi të cilat ai/ajo bën vetëvlerësimin e punës së tij/saj. *P.sh.: mund t'i kërkohet nxënësit të hartojë një skedë vetëkorrigjimi, për të korrigjuar me shkrim gabimet më të shpeshta dhe, më pas, ai/ajo ta integrojë korrigjimin në veprimtarinë e kërkuar.*

### **XIII. Materiale dhe burime mësimore**

Për arritjen me sukses të kompetencave në fushën e TIK-ut dhe teknologjisë është e rëndësishme të përdoren materiale dhe burime mësimore që japin një informacion të kuptueshëm për moshën e nxënësit dhe që e ndihmojnë atë të zhvillojë aftësi, shkathtësi, njohuri dhe qëndrime të nevojshme për të mësuarin gjatë gjithë jetës. Njëri nga burimet e thjeshta mësimore , që përdoret shpesh nga nxënësit dhe mësuesit, është teksti mësimor. Mirëpo me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe të shtimit të informacionit digjital, mësuesi duhet ta shohë tekstin më tepër si një burim nxitës por jo të mjaftueshëm për të zhvilluar kompetencat kyçe te nxënësit.

Mësuesit mund të bashkëpunojnë online me mësues të shkollave të tjera për të gjetur burime të besueshme informacioni, që u vijnë në ndihmë jo vetëm nxënësve për të zhvilluar aftësitë e tyre, por edhe mësuesve për të zhvilluar një qasje të re metodike. Nëpërmjet rritjes së shumë llojshmërisë së burimeve ne nxisim më shumë nxënësit të zhvillojnë mendimin kritik, krijues dhe problemzgjdhës gjatë procesit mësimor.

Disa nga burimet që mund të përdoren nga mësuesit për zhvillimin e orës mësimore mund të jenë: bibliotekat elektronike, broshurat informuese apo ndërfaqësuese, enciklopeditë, software elektronike në funksion të të nxënësve, studimet shkencore me fokus tek teknologjia dhe TIK-u etj.

Gjithashtu në bashkëpunim me nxënësit dhe shkollat mund të organizohen seminare të ndryshme mësimore dhe punimet më të mira të publikohen dhe t'u vihen në dispozicion të gjitha shkollave. Në ditët e sotme, ndodh shpesh që nxënësi të jetë një hap përpara mësuesit për sa u përket informacioneve elektronike, prandaj mësuesit mund të krijojnë forume mësimore bashkë me nxënësit për të krijuar materiale në ndihmë të procesit mësimor.